



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 19.12.2013, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1) Miratimi i procesverbalit.

2) Diskutimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2014” me këto institucione: Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Luan Duzha, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Vexhi Muçmataj dhe Mhill Fufi.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Gent Strazimiri, Tom Doshi dhe Keltis Kruja

Të ftuar:

Ambriola Misto – sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë

Auser Rama – përgjegjëse e Sektorit të Financave në Ministrinë e Drejtësisë
Genti Kosumi- sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme
Fjorida Ballauri – drejtore kabineti në Prokurorinë e Përgjithshme
Luan Abazi- drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e
Përgjithshme
Alaudin Malaj – zëvendëskryetar i Bordit drejtues të Zyrës së Administrimit të
Buxhetit Gjyqësor.
Luljeta Laze- drejtore e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.
Pjerin Prendi – sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Drejtësisë
Xhevdet Haxhiu – drejtor i administratës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë
Arian Parruca - përgjegjës i Sektorit të Financës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë
Kujtim Osmani – sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Sheshi – drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në
Gjykatën Kushtetuese
Mimoza Dhëmbi – drejtore e Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Të nderuar kolegë, sot në rend të ditës kemi seanca dëgjimore për të diskutuar rreth projektbuxhetit me një sërë institucioneve: Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Fillojmë me Ministrinë e Drejtësisë, e cila përfaqësohet në këtë mbledhje nga sekretarja e Përgjithshme, zonja Ambriola Misto.

Ju lutem, zonja Misto, na bëni një ekspozitë të shkurtër, për shkak se kolegët janë në dijeni të buxhetit, pra i disponojnë shifrat e buxhetit.

Ambriola Misto – Përshëndetje!

Ministria e Drejtësisë, referuar edhe prioriteteve të qeverisë gjatë hartimit të kërkesave për projektbuxhetin e vitit 2014, ka pasur si objektiv prioritar të saj që ky të jetë buxheti i reformave të rëndësishme, ku do të konsistojë në modernizimin dhe dixhitalizimin e gjithë sistemit të drejtësisë.

Për vitin 2014 sistemit të Ministrisë së Drejtësisë i janë parashikuar fondet buxhetore në shumën 7 miliardë e 661 milionë e 440 mijë lekë. Edhe pse në kushte jo të mira ekonomike të vendit, referuar krahasimit që ne bëjmë me buxhetin e vitit 2013, rritja në total për vitin 2014 është në shumën 1 miliard e 584 milionë e 140 mijë lekë, pra rreth 15,6 milionë dollarë krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2013.

Fondet për investime janë në vlerën 1 miliard e 155 milionë lekë, nga të cilat 500 milionë lekë është rritja e buxhetit të investimeve në krahasim me vitin 2013, duke e çuar në 950 milionë e 200 mijë totalin e këtyre fondeve të parashikuara për zbatimin e projekteve në bashkëfinancim me Bashkimin Europian. Gjithashtu, aty është parashikuar edhe ndërtimi i pallatit të drejtësisë, si dhe për ndërtimin e burgjeve dhe paraburgimeve të reja në Fier, Berat dhe Shkodër.

20 milionë lekë më shumë në krahasim me vitin 2013 janë fondet e parashikuara për përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë si rikonstrukcione të IEVP-ve, pajisje për ekspertizën mjeko-ligjore etj.

Duhet theksuar se janë parashikuar 35 milionë lekë më shumë fonde dhe investime për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë. 600 milionë lekë më shumë janë parashikuar në vitin 2014 për investimet me financim të huaj.

Shpenzime operative në vlerën 180 milionë lekë më shumë janë parashikuar për vitin 2014 si më poshtë vijon:

75 milionë lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të të gjithë sistemit të drejtësisë.

90 milionë lekë më shumë janë parashikuar në buxhetin e vitit 2014 për IEVP-të në funksion të përmirësimit të kushteve të institucionit të vuajtjes së dënimeve penale në përputhje me standardet europiane. Sistemi i burgjeve, duhet theksuar, prej shumë vitesh është përballur me një buxhet me mangësi të theksuar, duke krijuar kështu vështirësi në plotësimin e nevojave të domosdoshme të këtyre IEVP-ve.

15 milionë lekë janë për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Reformës Ligjore, si një organ konsultativ, si një strukturë e posaçme kolegjiale juridike, e cila do të jetë një bërthamë profesionale.

Buxheti për kompensimin financiar të ish-pronarëve nuk ka ndryshuar edhe për vitin 2014. Fondi i vënë në dispozicion në këtë zë është po 300 milionë lekë. Në këtë pjesë duhet theksuar se edhe pse fondi mbetet sa çka qenë i parashikuar në vitin e kaluar, gjatë vitit të kaluar procedurat për kompensimin financiar kanë filluar me shumë vonesë. Vonesat në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave ka qenë një tregues jo i mirë për atë periudhë. Për vetëm dy muaj janë shqyrtuar rreth 200 dosje në krahasim me 156 dosje, të cilat janë shqyrtuar për periudhën janar-shtator 2013.

Agjencia e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave do të bëjë shlyerjen për 45 dosje që përmbushin kriteret e kompensimit monetar. Vlera e kompensimit kap shifrën 200 milionë lekë. Fondi i mbetur prej 100 milionë lekësh, i cili nuk është arritur të përdoret, nga 300 milionë të akorduara për vitin 2013, do t'i shtohet e do të alokohet për vitin 2014. Pra, kjo rritje prek kryesisht zërin e investimeve, gjë që tregon për investimin e shtetit shqiptar për përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve ndaj ish-pronarëve.

Dua të bëj një përmbledhje krahasuese të vitit 2013 dhe vitit 2014 të buxhetit të sistemit të Ministrisë së Drejtësisë për programin e burgjeve. Fondet e akorduara për vitin

2013 kanë qenë 4.3 miliardë lekë. Fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 4.5 miliardë lekë, pra 225 milionë lekë më shumë se në vitin 2013.

Për programin e mjekësisë ligjore fondet e akorduara për vitin 2013 janë 48 milionë lekë, fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 63 milionë lekë, pra 15 milionë lekë më shumë se në vitin 2013.

Për programin e planifikimit të menaxhimit administrim fondet e parashikuara për vitin 2013 kanë qenë 1 miliard lekë, fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 2,3 miliardë lekë, pra 1.3 miliardë lekë më shumë se në vitin 2013.

Për programin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave fondet e akorduara për vitin 2013 ishin 425 milionë lekë, fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 431 milionë lekë, pra rreth 6 milionë lekë më shumë se në vitin 2013.

Për programin e botimeve zyrtare fondet e akorduara për vitin 2013 ishin 49 milionë lekë, fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 49.9 milionë lekë, pra 900 mijë lekë më shumë se në vitin 2013.

Për programin e shërbimit kombëtar të birësimeve fondet e parashikuara për vitin 2013 janë 12 milionë lekë, ndërsa fondet e parashikuara për vitin 2014 janë 13 milionë lekë, pra rreth 1 milion lekë më shumë se në vitin 2013.

Ky ishte parashikimi i Ministrisë së Drejtësisë referuar kërkesave që ne kemi bërë për projektbuxhetin.

Për sa i përket parashikimit të buxhetit të gjyqësorit, edhe pse do të vijë ta përfaqësojë vetë drejtoria përkatëse, referuar buxhetit total të propozuar parashikimi për pushtetin gjyqësor ka qenë rreth 20% më shumë kundrejt buxhetit total të miratuar të vitit 2013, gjë që rrit pavarësinë e gjyqësorit. Pavarësia financiare sjell automatikisht edhe rritjen e pavarësisë së këtij sistemi. Gjithashtu është marrë në konsideratë edhe rritja e numrit të punonjësve. Referuar edhe fillimit të punës së gjykatave Administrative, do të shtohen rreth 100 punonjës në mbarë vendin për mirëfunksionimin e të gjitha këtyre gjykatave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Misto!

Ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Misto, për paraqitjen e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë!

Nga ekspozēja juaj kuptova se keni një rritje të buxhetit si Ministri Drejtësie dhe e vlerësoj qeverinë që ka bërë këtë përmirësim.

Unë kam dy pyetje lidhur me dy zëra: për ndihmën juridike falas dhe për burgjet.

Për sa i përket ndihmës juridike falas, ne vjet kemi miratuar disa përmirësime në ligj për ndihmën juridike dhe në vitin 2014 hapen zyrat rajonale të ndihmës juridike falas. Sa është buxheti për këtë ndihmë në krahasim me vitin 2013? Duhet të kemi parasysh këtu edhe një vërejtje të Komisionit European që ndihma juridike është në mëshirë të fatit, është hall i madh me njerëzit e varfër që nuk kanë mundësi të mbrohen e të përfaqësohen.

Pyetja e dytë ka të bëjë me burgjet e reja. Ndoshta e dëgjova gabim, është menduar të hapen burgje të reja dhe vende paraburgimi. Ndërkohë që fondet për shërbimin e provës nuk lëvizin. Ju kërkoni të rikonstruktoni vendet e paraburgimit që ekzistojnë aktualisht apo keni menduar të ndërtoni burgje nga fillimi?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet për këto pyetje?

Po, ju lutem, prezantohuni.

Auser Rama – Jam përgjegjëse e Sektorit të Financave në Ministrinë e Drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Auser Rama – Lidhur me pyetjen e parë për buxhetin e parashikuar për ndihmën juridike, po ju them se që në fazën e parë të hartimit të projektbuxhetit janë përthithur kërkesat nga institucioni përkatës, ku është marrë në konsideratë edhe kërkesa e tyre për një fond shtesë në zërin shpenzime operative me objekt këshillimin juridik. Ky zë kap vlerën 4 milionë lekë të rinj. Të gjitha këto janë në zërin “shpenzime operative”, sepse janë me objekt qiramarrjen.

Lidhur me fondin për investime për burgjet, po ju them se janë objekte në proces ndërtimi: paraburgimi Fier, paraburgimi Berat dhe qendra e burgut Shkodër. Këto janë tri objekte në vazhdim dhe janë me financim të përbashkët me Bashkimin European.

Për mbikëqyrjen elektronike është një projekt i nisur që në vitin 2012. Në vitin 2013 është parashikuar një fond prej 70 milionë lekësh. Ky fond nuk u realizua plotësisht, u realizua në masën 32% për shkak të mos realizimit të procedurave të prokurimit brenda afateve të parashikuara. Për vitin 2014 kemi parashikuar një fond 30 milionë lekë me objekt mbikëqyrjen elektronike në fushën penale.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, ju lutem, ky nuk është vend që mund të bëni debat. Bëtë pyetjen, do t’ju japë përgjigjen.

Ambriola Misto - Për projektin e mbikëqyrjes elektronike, që lidhet drejtpërdrejt edhe me shërbimin e provës, është parashikuar një fond prej 35 milionë lekësh. Nga fondi i vitit 2013 prej 70 milionësh është përdorur vetëm 22.1 milionë lekë. Referuar fondit që ne kemi të akorduar për këtë vit, ne presupozojmë që kjo të ketë një shtrirje në të gjithë vendin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Të ndalojmë pak te çështja që ngriti zonja Hysi. Këto janë çështje që kanë të bëjnë me progresraportin dhe janë angazhime që ne i kemi marrë para pak muajve. Nuk e di është futur apo jo në buxhet çështja e zgjerimit të kapaciteteve të shërbimit të provës, përveç pjesës së mbikëqyrjes elektronike, për atë që tha edhe zonja e Financave, jam dakord, është normal dhe është i mjaftueshëm edhe ai fond që është miratuar.

Për çështjen e shërbimit të provës Bashkimi European ka kërkuar dhe e ka futur në progresraport dhe ne kemi premtuar që do ta bënim në vitin 2014. Pyetja është: A do të ketë zgjerim ky shërbim? Zgjerim do të thotë hapje të zyrave të shërbimit të provës, e para. Për përmirësim të infrastrukturës së shërbimit të provës duhen makina, zyra dhe zgjerim të numrit të punonjësve të shërbimit të provës. Këto të tria janë parashikuar në buxhetin e vitit 2014?

Buxheti i kërkuar në atë kohë nga Bashkimi European ka qenë rreth 4 milionë euro dhe ne i kemi premtuar që do të investohet. A është parashikuar, apo jo? Kjo është pyetja e parë.

E dyta, përsëri edhe kjo është në progresraport. Angazhimi që është marrë para Bashkimit European është hapja e zyrave të reja të ndihmës juridike. A do të hapen zyra të reja? A do të rritet numri i punonjësve? Është parashikuar? Nuk është parashikuar.

E treta, thatë që është rritur buxheti për burgjet nga 4.2 në 4.5. A ka ndërmend Ministria e Drejtësisë të fillojë ndonjë objekt ndërtimor të ri gjatë vitit 2014 apo janë vazhdim i atyre të mëparshme dhe ndryshimi ka të bëjë vetëm me rritjen e kostos lokale?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Auser Rama – Për çdo institucion varësie u jemi referuar kërkesave të ardhura prej tyre, që rendin prioritetet e tyre.

Institucioni i shërbimit të provës në fazën e hartimit dhe paraqitjes së kërkesave në projektbuxhet, për hir të së vërtetës, pati vonesa në paraqitjen e kërkesave. Kjo ishte një nga arsyet që efekti nuk arriti të llogaritej në buxhetin e vitit 2014. Pra ishte një problem brenda për brenda institucionit. Ky institucion duhet të ishte i pari që të ngrinte problemin për nevojat shtesë të fondeve.

Buxheti i vitit 2014 për shërbimin e provës është në kufijtë e buxhetit të vitit 2013 dhe arsyeja është se drejtuesit e mëparshëm nuk i kanë paraqitur kërkesat brenda afateve.

Programi i burgjeve në zërin investime ka shtesë fondi në vlerën 18 milionë lekë dhe këtë me objekt përmirësimin e kushteve në IEVP-të me zërat përkatës, ku brenda ka edhe dixhitalizimet.

Për sa u përket burgjeve, puna është në vazhdim. Prioritet janë mbylljet e objekteve në ndërtim.

Ambriola Misto – Ne po përfundojmë ato që janë lënë përgjysmë. Të paktën të krijojmë kushtet minimale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për komentet!

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë!

Tani e ka radhën Prokuroria e Përgjithshme, e cila përfaqësohet në këtë seancë dëgjimore nga zoti Genti Kosumi, sekretar i Përgjithshëm, zonja Fjorida Ballauri, drejtore e Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe zoti Luan Abazi, drejtor i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse.

Zoti Kosumi, besoj se ju do të jepni një përmbledhje të shkurtër të kërkesave që keni.

Genti Kosumi – Përshëndetje! Krahas krahasimit me kërkesat e paraqitura nga ana jonë në projektbuxhetin e vitit 2014, na rezulton se kërkesat e Prokurorisë së përgjithshme për fondet buxhetore për ushtrimin e detyrave kushtetuese në vitin 2014, janë marrë në konsideratë dhe janë paraqitur për miratim. Ky buxhet ka një rritje rreth 20% në krahasim me buxhetin e një viti më parë. Rritja është e dukshme, sidomos në zërin e pagave, të sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative. Do të kërkonim mirëkuptimin tuaj për mundësinë e shtimit të buxhetit në zërin “shpenzime kapitale”, një shumë prej 15 milionë lekësh, e cila mendojmë se e bën të mundur përfundimin e disa projekteve dhe disa nevojave emergjente për investime në disa prokurori. Do të theksoj këtu se disa prokurori, konkretisht te ajo e Pogradecit, Elbasanit dhe e Kavajës, kemi nevoja emergjente, qoftë për shtimin e ambienteve të zyrave, qoftë për përmirësimin e kushteve në këto prokurori. Në lidhje me numrin e punonjësve, te ky projektbuxhet nuk kemi paraqitur kërkesë për shtim të numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, se këtë e kemi lidhur me mundësinë e shtimit të kompetencës të Prokurorisë së Krimeve të Rënda për veprat korruptive, ligj që është në shqyrtim. Ky shtim i kompetencave të Prokurorisë së Krimeve të Rënda do të shoqërohet dhe me një faturë financiare që lidhet me shtimin e numrit të prokurorëve dhe të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Kosumi!

A ka pyetje, përpara se zonja Dhëmbi të reagojë ndaj kërkesave të Prokurorisë? Nuk ka.

Mimoza Dhëmbi – Siç u tha edhe nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, ka një shtesë të konsiderueshme në fondet për pagat, duke reflektuar ligjin “Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pa ndryshuar numrin e punonjësve. Ndryshimi i punonjësve nuk mund të merret parasysh në këtë buxhet, pasi ligji nuk është miratuar akoma. Fatura vjen pasi miratohet ky ligj. Në lidhje me investimet, ne kemi bërë maksimumin. Kemi vendosur një shifër që është më e madhe se ajo e një viti më parë, duke marrë parasysh zbatimin e projekteve në vazhdim, si dhe mbështetjen e një financimi të huaj që ka për një projekt Prokuroria e Përgjithshme. Mendojmë që Prokuroria mund të shohë mundësinë që brenda këtij totali të rialokojë fondet. Kjo do të ishte zgjidhja më e lehtë për ne. Nëse ka mundësi të heqë nga një projekt tjetër dhe të vendosë për Pogradecin. Do të kërkoja mirëkuptimin e tyre.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kuptoj se çfarë mirëkuptimi mund të kërkontë: një gjë që ia keni dhënë, besoj se e keni studiuar më parë. Këtë historinë e tri prokurorëve e dëgjoj sistematikisht që prej katër vjetësh që kam unë këtu. Kjo nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Për Shkodrën u dha vitin e kaluar. Të paktën, për njërin nga këto duhet të bëni një ndarje...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse është zgjidhur Pogradeci, mund të shikojmë këtë të Elbasanit.

Genti Kosumi – Prokuroria e Pogradecit është akoma në një proces të pazgjidhur. Ministrisë së Drejtësisë i jemi drejtuar dy herë me kërkesa në lidhje me këto ambiente që përmend zoti deputet. Kemi shtruar dy alternativa: ose ambientet te gjykata e Pogradecit, ose te godina ku ndodhet prokuroria. Prokuroria ka vetëm pesë zyra në katin e tretë. Të kemi mundësinë të marrim edhe katin e parë dhe të dytin, që përsëri janë të kësaj ministrie.

Fatmir Xhafaj – Ju i jeni drejtuar ministrit dhe tashti ish-ministri po thotë: “Atë që s’e bëra unë, ta bëjë ky tjetri”. Ju siguroj se do të flas me ministrin e Drejtësisë që të shikojmë e të gjejmë një zgjidhje. Zonja Djëmbi, do t’ju lutesha që Prokuroria ta detajojë se cilat janë fondet që kërkon (pavarësisht nëse e merr atë për Pogradecin) për Elbasanin dhe çfarë mund të bëjmë ne. Ju lutem, zotërinj të Prokurorisë, deri nesër të bëni një specifikim të tillë. Një kopje do të na e jepni neve, ndërsa një tjetër do t’ia zonjës Dhëmbi, me qëllim që ta trajtojmë në fund të këtij shqyrtimi. Jemi dakord? Po.

Zoti Halimi.

Eduard Halimi – Rritja e fondit të Prokurorisë ka të bëjë me rritjen e pagave të prokurorëve. Edhe për këtë rritje të pagave, në progresraportin e fundit, BE-ja tha që se është e pamjaftueshme, sepse ata e lidhin rritjen e pagave me reduktimin e korrupsionit: sa më të larta të jenë pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, aq më shumë do të reduktohet edhe korrupsioni në prokurori dhe gjykata. Ndërkohë, sipas paketës së re, ai që fiton më shumë, paguan më shumë. Sa përfitojnë këta prokurorë në projektbuxhetin e vitit 2014?

Mimoza Dhëmbi – Nuk mund të jap një përgjigje ekzakte, sepse ka prokurorë të shkallës së parë, prokuror apeli apo të Prokurorisë së Përgjithshme, kështu që rrogat janë të diferencuara. Kam mendimin se prokurorët e rretheve vetëm do të përfitojnë, sepse me gjithë rritjen e rrogave nuk e di a e kapin nivelin e pagës 130 mijë, ku paguajnë të njëjtën

shumë. Ata janë shumica. Kur shkojmë më lart, numri është më i vogël, kështu që ata që paguajnë më shumë, do të jenë shumë pak në krahasim me totalin e numrit të prokurorëve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Faleminderit, zotërinj të Prokurorisë për shpjegimet dhe prezencën! Mos harroni detajimin për Ministrinë e Financave, për t’ju mbështetur në kërkesën tuaj.

Për sa i përket kërkesës që lidhet me numrin e ri të punonjësve, ndaj të njëjtin mendim me zonjën Dhëmbi: në momentin që do të miratohet ligji, ne jemi përsëri këtu dhe ju do t’i merrni ato fonde.

Faleminderit!

Nga Gjykata Kushtetuese vjen zoti Osmani.

Zoti Osmani, fjala për ju, për të bërë një përmbledhje prej dy minutash, sepse materialin e kemi përpara.

Kujtim Osmani – I nderuar zoti kryetar, faleminderit për ftesën! Përgjithësisht, ne jemi të kënaqur me buxhetin e dhënë, duke përjashtuar këto vërejtje të vogla për çështjen e investimeve. Këto i kemi përmbledhur në një dyfletësh. Janë pothuajse po ato që kemi dërguar në Ministrinë e Financave në muajin tetor. Janë gjëra që mendojmë se mund të rregullohen dhe plotësohen. Kemi pasur gjithmonë përkrahjen e Komisionit të Ligjeve, por këtë herë kemi shqetësim Komisionin e Ekonomisë, sesi do të na shkojë atje.

Fatmir Xhafaj – Të lutem, fokusoj te kërkesat e jo te batutat!

Kujtim Osmani – Si gjithmonë, jemi munduar të përsosim pak shërbimin e intranetit, me qëllim që të arrijmë të heqim dorë nga fotokopjimi i materialeve dhe dosjeve për gjyqtarët. Kemi menduar për të pasuruar bibliotekën tonë, e cila është tepër e varfër krahasuar me bibliotekat e gjykatave kushtetuese përreth nesh. Kryesisht, janë tituj që lidhen me gjykimin kushtetues, por që kushtojnë. Këto, në fakt, i shërbejnë edhe ndryshimeve që ka pësuar drejtësia kushtetuese e kohëve të fundit. Ndër të tjera, kemi edhe një kërkesë për përsosjen e rrjetit të sigurisë në komision, me qëllim që të jetë bashkëkohor.

Siç e përmenda kemi një projekt për informatizimin: për këtë gjë, kemi kontakte me një kompani turke, e cila ka dhënë kontribute në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Ajo na ka premtuar ndihmë. Shpresojmë që ky projekt, i cili kap vlerën 140 mijë dollarë, do

të përsosë marrëdhëniet e gjykatës me median dhe publikun. Këtu synojmë të ndërtojmë një sallë konferencash, që përfaqësuesit e medias të mos grumbullohen në sallën e gjyqimit, e cila është shumë e vogël, por t'i vendosim në një ambient të përshtatshëm ku të kenë mundësi ta ndjekin procesin në gjykatë kushtetuese. Vetë godina ku jemi vendosur, ose më saktë jemi bujtës, pasi Gjykata Kushtetuese nuk ka një godinë më vete, është e vjetër dhe ka nevojë për rregullime dhe rikonstruksione, siç janë rrjetet hidraulike, elektrike, dhe pajisjet për zyra që kërkojnë rinovim, pasi teknologjia ka ecur përpara. Të gjitha këto kapin një vlerë 13 milionë lekë.

Fatmir Xhafaj – Investimet?

Kujtim Osmani – Investimet.

Fatmir Xhafaj – Edhe ai problemi i makinave tuaja?

Kujtim Osmani – Edhe ai.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Ka pyetje? S'ka.

Zonja Dhëmbi, para se të flisni, doja t'ju thosha dy gjëra. E para, zoti Osmani nuk ka dalë asnjëherë nga ky komision pa marrë diçka. E dyta, atë punën e banjave ka nja dhjetë vjet që e dëgjoj në këtë komision. Nuk është serioze.

Mimoza Dhëmbi – Në vijim të komentit tuaj, zoti Xhafaj, mund të them se me buxhetin që kemi përgatitur për Gjykatën Kushtetuese për këtë vit kemi eliminuar një pjesë të kërkesave të herëpashershme: 2 milionë lekë më shumë te shpenzimet korente, te pagat, sigurimet etj. Meqë këtë vit nuk kemi projekte të reja, sepse kemi si synim të stabilizojmë situatën e nivelit të lartë të borxhit etj., unë mendoj se ai problem mund të shtyhet. Kur të kemi stabilizuar financën publike, mund të fillojmë me projektet e reja dhe komplekse, siç është ky që na paraqitet. Nuk jemi kundër, por 13 milionë, në krahasim me një buxhet 2-3 milionë që këta marrin investime, është shumë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por të paktën këto rikonstruksionet: bëhet fjalë për 1 milion lekë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Kjo shtesë fondi detajohet.

Bashkim Fino – Kam një koment.

Fatmir Xhafaj – Nuk lejohen komentet: vetëm pyetjet.

Bashkim Fino – Një koment.

Fatmir Xhafaj – Ju keni të drejtë në fakt, sepse jeni relatori.

Bashkim Fino – A e di si është problemi, kryetar? Këta kërkojnë një sallë moderne, e cila duhet. Patjetër. Po kur ne nuk kemi rregulluar kushtet këtu, në këtë sallë, ku mediat i rrinë te koka e kryetarit dhe e nënkryetarit, si mund të rregullojmë kushtet e tyre? Këta duan siguri tani! Rëndësi ka t'u japim shpenzimet e domosdoshme. Akoma nuk është sqaruar nëse këta do të rrinë aty ku janë apo do të shkojnë te Pallati i Drejtësisë apo ndonjë godinë tjetër. Pra, të bëhet në kuadrin e përgjithshëm. Nëse do të ngelen aty, ai investim është i domosdoshëm. Mendoj se është diçka e pranueshme, por pak e parakohshme.

Mimoza Dhëmbi – Nëse bëhet fjalë për shifra 1 apo 2 milionë lekë, mund ta paraqisni si kërkesë dhe pastaj ne ta shohim në Komisionin e Ekonomisë.

Kujtim Osmani – Zoti kryetar, unë kam punuar 25 vjet prokuror, prandaj e gjej gjuhën me ju. Kuptohet, kur i paraqes kërkesat, ato janë të arsyeshme. Bëhet fjalë për një projekt 140 mijë dollarë, të cilin në fakt nuk e kërkojmë nga shteti, pasi do të bëjmë edhe përpjekje që të gjejmë donatorë. Jemi me këmbë në tokë në kërkesat tona.

Fatmir Xhafaj – Do t'ju lutesha që bashkë me këshilltarin, Bledin, i cili po merret me përgatitjen e këtij dokumenti, të bisedoni se cilat janë disa detaje që, nga gjithë kjo kërkesë, në këto kushte që jemi, pavarësisht rritjes së madhe të buxhetit për Gjykatën Kushtetuese, të mund të përfshijmë më të domosdoshmet.

Falënderoj zotërinjtë e Gjykatës Kushtetuese dhe zonjën Dhëmbi për disponibilitetin e vazhdueshëm ndaj Gjykatës Kushtetuese!

Ftojme Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, që është zyra kryesore për administrimin e buxhetit në sistem, ajo që mban edhe peshën kryesore, dhe që përfaqësohet këtu nga zoti Alaudin Malaj, zëvendëskryetar i Bordit Drejtues të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, njëkohësisht edhe kryetar i Gjykatës së Apelit të Tiranës, dhe nga zonja Luljeta Laze, drejtoreshë e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Fjalën e ka zoti Malaj për një përmbledhje të shkurtër.

Alaudin Malaj – Në lidhje me buxhetin për pushtetin gjyqësor për vitin 2014, ne në mënyrë të detajuar, duke u nisur nga Komisioni i Buxhetit pranë Konferencës Gjyqësore, kemi paraqitur kërkesë pranë jush për plotësimin e të gjitha kërkesave

buxhetore të pushtetit gjyqësor. Në fakt, siç e shohim nga kërkesa që ka bërë Komisioni i Buxhetit i Konferencës Gjyqësore te ju është plotësuar një pjesë goxha e konsiderueshme lidhur me buxhetin për këtë vit. Buxheti ka një rritje prej 20% kundrejt buxhetit total të miratuar për vitin 2013, është parashikuar një rritje prej 22% në shpenzimet e personelit dhe ajo që vlen më tepër, janë rritur 16% shpenzimet operative në ndryshim nga vitet e tjera. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e krijimit të gjykatave administrative dhe gjykatave të tjera, të cilat kanë kërkuar domosdoshmërisht rritjen e këtyre zërave.

I vetmi shqetësim që kemi ne janë shpenzimet për investime për gjykatat. Sigurisht që janë parashikuar 110 milionë, ashtu si edhe vitin që shkoi, por ne mendojmë se duhet të shkojë në 210 zëri i shpenzimeve për investimet për shkak të mirëfunksionimit të gjykatave administrative, pajisjes së tyre me servera, me kompjutera, me të gjithë procedurën e domosdoshme për zhvillimin e gjykimin normal dhe krijimin e një shërbimi, si dhe për të krijuar ambientet e domosdoshme dhe të nevojshme për funksionimin e gjykatave. Për shembull, ne kemi probleme investimesh në dy gjykata, në atë të Apelit të Shkodrës dhe të Shkallës së Parë në Elbasan, të cilat kërkojnë patjetër një investim të domosdoshëm dhe ndërhyrje të menjëhershme, siç dhe kemi për Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak se Gjykata Ushtarake që u përshtat për Gjykatën Administrative nuk ka pasur salla të pritjes së publikut, nuk ka pasur zyra dhe ambiente të domosdoshme për plotësimin e të gjithë kuadrit të nëpunësve të gjykatës. Pra, sot në atë gjykatë nuk ka mundësi reale për mirëfunksionimin e gjykatës, duke u nisur që nga stafi i gjykatës deri te shërbimi i publikut. E vetmja kërkesë për të cilën ne ngulmojmë është kjo në lidhje me rritjen e zërit të investimeve.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje?

Armando Subashi – Jo se nuk i dinim problemet që kanë të bëjnë me infrastrukturën e gjykatave administrative, por është mirë që u thanë edhe nga ana juaj këtu në komision. Kur kemi diskutuar dhe miratuar atë ligj, një nga kushtet ka qenë krijimi dhe përfundimi i të gjithë infrastrukturës së atyre gjykatave dhe jo pa qëllim vendosëm që funksionimi i gjykatave të bëhej me dekret të Presidentit të Republikës pasi të plotësoheshin të gjitha këto kushte. Sot gjykatat administrative kanë filluar punën dhe ju na thoni që ato nuk kanë as personel, as salla, as kompjutera, as mjete të tjera për të vazhduar normalisht punën. Sigurisht që kjo është një përgjegjësi e Këshillit të Lartë të

Drejtësisë dhe e Presidentit të Republikës, të cilët kanë vendosur fillimin e kësaj veprimtarie në kundërshtim flagrant me ato kushte që ne kemi vënë në ligj.

Unë do të kisha një thirrje për zonjën Dhëmbi, se ndoshta është momenti i duhur, që kërkesat e gjyqësorit ne t'i shohim me përparësi dhe duhet të shikojmë realisht të gjitha mundësitë që mund të na ofrojë ky buxhet, me të gjitha ato probleme që ne i dimë që i ka, për të mbushur sadopak kërkesat e tyre. Në radhë të parë për të riparuar të gjithë atë problem që është krijuar me funksionimin normal të gjykatave administrative, besoj kjo është e para dhe më e rëndësishmja, dhe, së dyti, të shikojmë edhe mundësinë e plotësimit të një prej kërkesave që sot u bënë këtu, duke e lidhur edhe me ato çka parashtroi prokuroria. Ndoshta Elbasani, them unë, mund të ishte qyteti i duhur, ku edhe gjykata, edhe prokuroria kanë nevojë për një projekt dhe për një investim bashkëkohor, sepse ne jemi koshientë që është një nga qytetet më të mëdha, por që ka ngelur me gjykatë dhe me prokurori shumë të amortizuar, shumë të vjetër dhe jashtë çdo kushti që do të garantonte funksionimin normal të tyre.

Zonja Dhëmbi, për ju e kam këtë sugjerim, sa është e mundur që ne t'i shohim pak me përparësi kërkesat e gjyqësorit?

Mimoza Dhëmbi – Në fakt, duke parë listën e investimeve të Zyrës së Administrimit të Pushtetit Gjyqësor, unë shoh që kemi rreth 32 milionë lekë investime për gjykatat administrative. Nevojat mund të jenë shumë më të mëdha, megjithatë, nga pikëpamja e shpenzimeve korrente këto gjykata janë mbështetur me fond page, me numër punonjësish, me fonde operative dhe për herë të parë kemi një mirëkuptim që këto gjykata të funksionojnë normalisht.

Lidhur me investimet mirë është që të kemi një argumentim të veçantë për kërkesën shtesë dhe të përzgjidhet nga kërkesa shtesë ajo që është më emergjente.

Kam diçka te numri i punonjësve, sepse është bërë një lapsus, është shtuar dy herë kërkesa për numrin e punonjësve të gjykatave administrative. Unë mendoj që ne mund të shikojmë te 1300, ta korrigjojmë numrin, sepse edhe fondi i pagave është dhënë po për 100 vetë. Ky është gabimi ynë.

Fatmir Xhafaj – Dy gjëra kuptova unë nga ndërhyrja e zonjës Dhëmbi: një detajim më të mirë të kërkesës suaj për investime, në mënyrë që të shikojnë se çfarë

mbështetje mund të bëjmë, sepse kërkesa e zotit Malaj, me sa kuptova, është në investime; dhe një saktësim për numrin e buxhetit.

Zonja Laze tani duhet të përgjigjet nëse përputhet.

Luljeta Laze – Për sa i përket numrit të punonjësve kërkesa jonë ka qenë për 100, që plotëson nevojën edhe për funksionimin e gjykatave administrative, edhe për disa nevoja të tjera të vogla që kanë qenë në një plan të moderuar, që është bërë vit pas viti për nevojat që kanë pasur gjykatat në vijimësi për shtesë të numrit të punonjësve. Kështu që mendoj se një shtesë prej 100 punonjësish do të jetë e konsiderueshme. Gjithsesi këtu jemi dhe mund të saktësohen përsëri në fund të vitit të ardhshëm, duke parë edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe problemet e tjera.

Edhe fondi i pagave është i mjaftueshëm për shtesën prej 100 punonjësish, pasi kur ka filluar Gjykata Administrative, më 4 nëntor, nuk është shoqëruar as me shtesë të numrit të punonjësve, as me shtesa buxhetore, kështu që vërtet kishte dy muaj për të funksionuar, por gjithsesi sforcimi në funksionimin e tyre ndihet.

Për sa i përket shtesës që kërkojmë për investime. Megjithatë mendoj se e kemi shumë të detajuar kërkesën, që është bërë me kohë dhe që është paraqitur në Ministrinë e Financave, gjithsesi në një pamje të përgjithshme, unë mund të jap dy, tri elemente. Pjesën më të madhe të fondit të investimeve ne na i zënë shpenzimet për të mbajtur në gjendje pune dhe për të mos shkaktuar asnjë ndërprerje për funksionimin dixhital të gjykatave. Sivjet fillojnë punë shtatë gjykata të reja, duke bërë që të ketë nevoja shtesë në këtë drejtim, sepse vetëm servera duhet të shtohen 7. Le të shtojmë këtu edhe nevojën e shtuar, sepse jo çdo vit ne kemi pasur fonde mjaftueshëm për të plotësuar nevojat. Kështu që është bërë emergjencë edhe shtimi i shtatë serverëve të tjerë në gjykatat ekzistuese, po kur bëhet fjalë për serverin, bëhet fjalë për kyçin nga ku funksionon gjithë gjykata në sistemin dixhital dhe nuk duam të ketë asnjë ndërprerje. Pra, vit për vit i kemi kushtuar vëmendje kësaj. Një fond relativisht i vogël shkon edhe për pajisje, sepse kur shtohen sipërfaqet e punës, shtohen edhe pajisjet.

Ne në kërkesën tonë që kemi çuar në Ministrinë e Financave kemi pasur 62 milionë lekë vetëm për pjesën elektronike. Gjithsesi, në pjesën e programimit që bëhet sigurisht që çdo institucion bën më të mirën e mundshme, prandaj kuptohen edhe firot që vijnë nga buxhetet që merren. Pjesa që mbetet është e pamjaftueshme për të filluar një

projekt të ri për ndërtimin e gjykatave, sepse nga ndryshimi i gjyqtarëve dalin disa prioritete herë pas here. Është shtuar numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Durrësit, por ata nuk kanë zyra përkatëse për të filluar punë. Pra, je i detyruar të bësh një rikonstrukcion që të krijosh ambientet e punës, të shtosh sallën e gjyqit se për tre gjyqtarë patjetër që duhet dhe një sallë gjyqi. Në Gjykatën e Apelit të Vlorës është shtuar numri i gjyqtarëve, megjithëse janë gjëra të vogla, kërkojnë një impenjim dhe fonde të caktuara sado të vogla që të jenë.

Ajo që tha zoti Malaj për Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë është e vërtetë, është në kushte për të punuar, por fakti që Gjykata Ushtarake e Apelit ka funksionuar aty, ka një këndvështrim komplet tjetër, ajo gjykatë nuk kishte marrëdhënie me publikun, ndërkohë tani je i detyruar të ndërtosh një ambient për shërbimin e publikut dhe kjo është shumë e rëndësishme. Gjithashtu, sipas ligjit, kërkohet që të jenë ndihmësit ligjorë dhe ambiente për ndihmësit ligjorë nuk ka. Prandaj je i detyruar në këto kushte që përsëri të shtosh ambientet e punës.

Fakti që dalin problematika herë pas here dhe buxhetet janë të pamjaftueshme, nuk po fillojmë dot të ndërtojmë një gjykatë të re, kur i kemi projektet të gatshme, siç është Apeli i Shkodrës, siç është rrethi i Shkodrës, siç është rrethi i Elbasanit, ku janë 17 gjyqtarë me dy salla gjyqi. Po kur nuk i ke fondet në dispozicion, ose nuk ke pjesën më të madhe, se ne zakonisht praktikojmë që një ndërtim, një gjykatë në dy vjet të bëjmë. E kemi konsideruar si mënyrën më të mirë që një ndërtim ta bëjmë në dy vjet, sepse brenda një viti na është dukur e pamundur qoftë për pjesën e buxhetit që merr, qoftë për mënyrën si ecën ndërtimi. Prandaj themi që problematika kanë dalë nga krijimi i gjykatave administrative. Na marrin pjesën e investimeve që ne kishim planifikuar për të filluar me planin tonë strategjik të zhvillimit, kështu që do të thoshim: “Na jepni diçka shtesë, që ne të fillojmë një nga këto projekte që kemi nisur.” Ky ishte argumenti. Besoj se këto do të jenë edhe ato që do të çojmë më vonë, nëse do të kërkohet ndonjë detajim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Tani, zonja Dhëmbi, zonja Laze, çështjen e fondeve për Gjykatën Administrative kemi nja shtatë vjet që e diskutojmë në Komision. Para shtatë vjetësh diskutonim ngritjen e Gjykatës Administrative me njëzet milionë dollarë të

financuar nga ambasada amerikane, nga USAID-i, por u dogjën, nuk u bë. Pse? Sepse parafolësi nuk e jepte votën. Nuk u bënë ato 17 milionë euro, që i binte rreth 20 milionë dollarë. Edhe vitin e kaluar, edhe para tre vjetësh, edhe vjet diskutonim ligjin për Gjykatën Administrative dhe diskutonim hapjen e gjykatave administrative. Dhe nuk e dinim, edhe ju keni qenë skeptikë, më korrigjoni nëse gaboj, edhe këtu në Komision, nëse do t'ia jepnim lekët Gjykatës Administrative. Dhe po të mos kishin dhënë votën këta më 30 maj me kërkesën e Lëvizjes Socialiste për Integrim, nuk do të ishin hapur gjykatat administrative, as ato godina që u bënë, porse do të kishin fjetur siç kanë fjetur shtatë vjet me radhë. Akuza joserioze që iu bë këtu Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Presidentit, duhet të tërhiqet mbrapsht. E sigurisht, konfirmohet edhe nga njerëzit e Financës këtu. Sepse nuk i ndërtojnë gjykatat dhe nuk e jep miratimin ndërtimin e gjykatave dhe funksionimin e gjykatave as Këshilli i Lartë i Drejtësisë, as Presidenti i Republikës. Konfirmimin për funksionimin e gjykatave e jep ministri i Drejtësisë. Datën e fillimit të funksionimit të gjykatave e përcakton ministri i Drejtësisë. Dhe ishte ministri i Drejtësisë i kësaj qeverie që shkoi bashkë me ju dhe inauguroi Gjykatën Administrative, ndërsa më pas kërkoi fillimin e punës së kësaj Gjykate. Ndaj këto versione që keni brendapërbrenda qeverisë për të sulmuar a për t'i zënë vendin njërit apo tjetrit lërinë, sepse shkojnë në të kundërt të argumenteve që janë këtu. A ka sot ndonjë gjykatë administrative, zonja Laze, kur gjyqtarët nuk kanë kompjuterë, apo që nuk kanë zyra? Ka, apo nuk ka? Apo janë probleme të sekretarisë? Kjo është pyetja e parë. Dhe e dyta... *(Replikon me dikë në sallë.)* Boll, të tregohemi seriozë. Tërhiq akuzat, sepse nuk është kjo për të sulmuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Presidentin...

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, bëni pyetjen.

Eduard Halimi – Të bëhemi seriozë, se e vonuat... Të lutem shumë të bëhemi seriozë.

Fatmir Xhafaj – Bëj pyetjen, se është debat tjetër ai. Do të bëjmë debat tjetër dhe do të ta them unë çfarë ka ndodhur. Do të kesh kohë ta përcaktosh...

Eduard Halimi – Do të kem, do të kem, e di unë. I kemi të gjitha. Dhe a ka gjykata të reja? Do të fillojë ndonjë gjykatë e re gjatë vitit 2014, apo s'do të fillojë ndonjë gjykatë e re? Sepse rritja e buxhetit ka të bëjë vetëm me rritjen e pagave që bëjnë, apo jo?

Ai 20-përqindëshi dhe rritjen e administratës. A do fillojë ndonjë gjykatë e re, apo s' do të fillojë ndonjë gjykatë e re? Këtë pyetje kisha unë.

Fatmir Xhafaj – Për dy pyetjet, zonja Dhëmbi, zonja Laze.

Luljeta Laze – Atëherë, unë e përmenda edhe në fillim se fondi që në kemi kërkuar për të filluar gjykatat e reja e për të funksionuar normalisht edhe me elementet e tjera që ka gjykata ka qenë 410 milionë. Sigurisht që është kërkesë shumë e lartë, por ka qenë në vijimësi kërkesa jonë. Gjithmonë kemi pasur kërkesa të larta, sipas projekteve të mirëpërcaktuara. Fondin që do të marrim në dispozicion do ta analizojmë edhe njëherë kur të bëjmë detajimin e fondeve. Gjykatave, siç thashë pak më parë, prej disa vjetësh, që kur gjykatat funksionojnë në mënyrë të dixhitalizuar, u kemi kushtuar vëmendje të veçantë. Nuk na duket normale të fillojmë të ndërtojmë një gjykatë të re dhe, nga ana tjetër, të ndërpritet puna në mënyrë të dixhitalizuar dhe të kthehemi mbrapsht me standardet e të punohet në mënyrë manuale. Ajo që përmenda që në fillim është se fakti që fillojnë shtatë gjykata të reja do të marrë shumë fonde në dispozicion për pjesën e elektronikës. Përmenda...

Fatmir Xhafaj – Që të kuptoj unë, ky buxhet shtatë gjykatat e reja i realizon më së miri, i përmbush më së miri që të funksionojnë normalisht? Janë shtatë gjykata, nuk është një, janë shtatë. Atëherë këto shtatë gjykata me këtë buxhet funksionojnë normalisht? Mbështetet funksionimi normal i këtyre gjykatave?

Luljeta Laze – Aktiviteti i përditshëm po. Ashtu sikurse thamë. Nga shpenzimet operative, që janë në rritje, kurse për pjesën e infrastrukturës në kërkojmë fonde shtesë, për arsye se kjo është një gjë që ka dalë tani me krijimin e gjykatave administrative. Ndërkohë duam të mbështesim në dy drejtime. Edhe këto, edhe pjesën e planit tonë strategjik të zhvillimit, i cili ka mbetur vazhdimisht i porealizuar.

(Replikon me dikë në sallë.)

Po, sigurisht, edhe me ndërtimin. Kjo është pjesa dixhitale dhe ne kërkojmë që gjithashtu të fillojmë edhe një projekt për të ndërtuar. Nëse nuk marrim ndonjë fond shtesë, nuk mund të fillojmë ndërtimin e ndonjë projekti të ri. Nëse nuk marrim ndonjë fond shtesë, do të mbetemi në këtë gjë, që të menaxhojmë mirë situatën, që të funksionojnë këto që janë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Zoti Malaj, ju lutem!

Alaudin Malaj – Një gjë vetëm sa për sqarim, që t'ua bëj të ditur edhe juve.

Në fakt, gjykatat tona sot kanë një standard tjetër gjykimi të çështjes. Në bazë të projekteve-pilotë të USAID-it, janë ndërtuar në të tëra gjykatat sistemet audio të gjykimit të çështjes. Sigurisht që sistemet audio janë përparimi më i madh në sistemin e drejtësisë të një shteti për zhvillimin e gjithë seancave gjyqësore dhe për ruajtjen e integritetit të gjykatave. Pikërisht kjo është një nga pikat kryesore së cilës ne i mësojmë, prandaj i kërkojmë edhe severat, prandaj i kërkojmë edhe ndryshimet e tjera, prandaj kërkojmë edhe kompjuterat. Për shkak të ndërtimit të këtyre sistemeve të reja. Sot në gjykatat tona, po them të Apelit të Tiranës, një seancë gjyqësore mund ta marrësh në CD, ta dëgjosh, ta komentosh e t'i bësh të gjitha gjërat e tjera. Nuk ka më nevojë të paraqitesh, po themi, të rrish të marrësh gjithë procesverbalet e t'i kërkojsh me radhë. I ke që të gjitha në CD. Ky është një shërbim shumë i thjeshtë për publikun, që paguan vetëm tarifën dhe merr shërbimin për ta dëgjuar vetë publiku seancën gjyqësore si e kanë zhvilluar gjyqtarët. Kjo është pikërisht ajo që po themi ne, se vendosja e këtyre sistemeve audio do të krijojë standard të ri në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Që nga mënyra e zhvillimit të gjykimeve nga gjyqtarët e deri te bindja e gjitha palëve në gjykim përballë gjykatës dhe ruajtjes së rregullave të kodeve e të procedurës. Ky është shqetësimi që kemi ne. Nuk është e vërtetë se sot Gjykata Administrativ e Apelit të Tiranës që nuk ka kompjuterë. I ka kompjuterët. Problemi është se i ka kompjuterët siç i kemi pasur ne para dhjetë vjetësh. E kanë pa një server qendror, kështu që vendosja e një sistemi qendror dhe lidhja me një sistem audio do t'i shërbente shumë mirë Gjykatës Administrative për të përcjellë mesazhin pikërisht te publiku. Se Gjykata Administrative mendoj se është një nga sfidat e reja të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, që nga të dyja palët politike është ndërmarrë si iniciativë. Ne nuk kemi probleme të tjera përveç këtij standardi të gjykimit të çështjeve. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Edhe njëherë, që të qartësohemi në gjithë këtë lumë fjalësh. Duke respektuar kërkesën e përfaqësuesve të zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor, duhet të ndajmë dy gjëra. Ajo që ka të bëjë me funksionimin normal të gjykatave administrative, nëse e kuptova zotin Malaj, është e domosdoshme një shtesë për funksionimin normal të

gjykatave administrative, por që ka të bëjë me sistemin e serverëve. Sepse kjo nuk është parashikuar në momentin që ato kanë filluar punë, kështu është, apo e kam gabim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të dëgjova. Mbjajte gjithë atë fjalim, ndiqe tashti. Sapo tha se i kanë kompjuterat. Ajo që po them unë është: si bëhet që të ndihmohen për pjesën e funksionimit për serverat, se ne nuk mund të vemi t'i kërkojmë përsëri USAID-it. USAID-i i bëri tridhjetë. Tani ne nuk jemi këtu për t'u mbajtur tek USAID-i. Faleminderit, faleminderit USAID-it! Edhe këta duhet t'i thonë “faleminderit” USAID-it, edhe ne i themi “shumë faleminderit!” Problemi është për këto tetë të tjerat, që s'i kanë bërë dot me USAID-in, se s'i parashikuan dot. Tashti, çfarë bëhet? Kemi mundësi t'i mbështesim me buxhetin tonë, apo jo? Që të mos merremi me llafë e t'i biem nga Kina për të ardhur në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë.

Mimoza Dhëmbi – Tani, nga buxheti e deri te kërkesa është një hendek i madh. Unë them që të vendosim një prioritet. Ta vendosim dhe t'i selektojmë kërkesat. Të mbështesim pa diskutim informatizimin. Me këtë standard të ri që kanë gjykatat, pa diskutim. Edhe unë e di sa i domosdoshëm është serveri, sepse edhe ne kemi sistemin tonë në Ministrinë e Financave, që është shumë i rëndësishëm. Ta mbështesim këtë plotësisht dhe të mbështesim infrastrukturën për gjykatat e reja administrative. Të mos mendojmë për të filluar gjykata të reja, rikonstruksione, sepse, po hapëm dhe këtë sherr pastaj, ne nuk mbarojmë kurrë. Të vendosim këtë prioritet dhe pastaj ta gjejmë se sa është kjo shumë.

Fatmir Xhafaj – A biem fillimisht dakord me këtë, pra për të bërë këtë rialokim shtesë? Pastaj ju brendapërbrenda do të shikoni a keni mundësi apo s'keni mundësi. Zonja Laze, të lutem, se të shikoj...

Luljeta Laze – Tani unë doja të dija nëse do të kemi ndonjë shtesë.

Fatmir Xhafaj – Po pra!

Luljeta Laze – Dakord, në qoftë se do të kemi shtesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, të lutem. Zoti Ndoka, të lutem! Unë po e drejtoj dhe po them shtesë. Më vjen keq. Atëherë, jemi në rregull?

Zonja Laze, a bie dakord?

Faleminderit zonja Dhëmbi, faleminderit zonja Laze, shumë faleminderit zoti Malaj për prezencën dhe për kontributin! Punë të mbarë!

Shpresoj se u morëm vesh për shtesën, për serverat dhe për funksionimin normal, për pajisjen me të gjitha të gjykatave administrative. Pjesën tjetër pastaj do ta negocioj unë me ministrin.

Faleminderit!

Vazhdojmë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili përfaqësohet në komision nga zoti Pjerin Prendi, sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, zoti Xhevdet Haxhiu, drejtor i administratës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe zoti Arian Parruca, përgjegjës i Sektorit të Financës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Arianin e njoh, sepse ka vite që vjen në këtë Komision. Me ju s’kisha pasur mundësi që të kontaktonim.

Faleminderit zoti Haxhiu! Faleminderit zoti Parruca!

Zoti Haxhiu, një përmbledhje të ekspozesë suaj, një ekspozë të shkurtër lidhur me çështjet e buxhetit, për të cilat jeni thirrur këtu.

Xhevdet Haxhiu – I nderuar zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Duke ju falënderuar për ftesën e bërë që të marr pjesë në këtë seancë dëgjimore për projektbuxhetin e vitit 2014, ne përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2014 është mbështetur në ligjin 99/36 të vitit 2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimin nr. 9 të vitit 2013 të Ministrisë së Financës për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe në parimin e efektivitetit e transparencës. Bazuar në treguesit e projektbuxhetit të paraqitur nga qeveria për shqyrtim dhe miratim, rezulton se për institucionin tonë fondet buxhetore, të cilat të ndahen sipas artikujve të shpenzimit janë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e dërguara nga ana jonë. Në këtë kontekst ne jemi dakord me projektbuxhetin e propozuar nga qeveria për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Nivelet e planifikimit të treguesve të hartuar nga ana jonë në projektbuxhetin e vitit 2014 për çdo artikull shpenzimesh janë në nivelet e tavaneve të përcaktuara në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave. Kërkesat janë hartuar në një program të vetëm, të emërtuar “Veprimtaria mbikëqyrëse e Këshillit të Lartë të

Drejtësisë”. Në këtë program kemi hartuar Deklaratën e Politikës së Programit, ku përcaktohet misioni, prioritetet, objektivat, si dhe standardet që synohen të arrihen.

Deklarata përcakton misionin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që është, dhënia e kontributit të vazhdueshëm në përmirësimin e funksionimit të pushtetit gjyqësor duke synuar forcimin e pavarësisë të sistemit gjyqësor rritjen e transparencës e paanshmërisë së këtij sistemi, si dhe rritjen e transparencës e besimit të publiku. Për arritjen e këtij misioni ne kemi hartuar, gjithashtu, edhe politikën e programit dhe objektivat përkatëse të tij. Në politikën e programit përcaktohet qartë roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për përmirësimin e pushtetit gjyqësor nëpërmjet monitorimit të veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave të ardhura në institucionin tonë, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale në vazhdimësi. Gjatë fazës së hartimit të kërkesave buxhetore është synuar tërheqja e mendimit të të gjitha strukturave përkatëse në institucionin tonë për të pasur një argumentim të plotë dhe sa më të drejtë në përcaktimin e shpenzimeve duke marrë parasysh edhe parimet e funksionimit të sistemit buxhetor, që janë: parashikueshmëria, transparenca dhe përdorimi ekonomik eficient dhe efektiv i fondeve buxhetore. Numri i punonjësve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është në total 50, sipas ligjit 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”. Programimi i fondeve në mënyrë analitike i ndarë në artikuj paraqitet si më poshtë:

Në artikullin 600, shpenzime për pagat, rezultojnë në vlerën 55500 mijë lekë, programimi i fondit të pagave është bërë duke u mbështetur në vendimin e këshillit të Ministrave 589/2013 “Për disa ndryshime të VKM-në nr. 545, datë 11.08.2011”: “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve civil, nëpunësve, zëvendësministrit, të nëpunësve të kabinetit të Kryeministrit, aparateve e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit etj”, si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 610 /24.07.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 717 “Për pagat e punonjësve mbështetës, të institucioneve buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore i ndryshuar”. Artikulli 601, shpenzime për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, rezulton në masën 8500 lekë, të cilat janë programuar, gjithashtu, duke u përlllogaritur sipas legjislacionit në fuqi.

Artikulli 602, mallrat dhe shërbimet e tjera, rezulton në masën 27 mijë lekë, i cili në mënyrë analitike është paraqitur si më poshtë :

Në nënartikullin 602, “materiale të zyrave të përgjithshme” në masën 3500 mijë lekë, në artikullin 602/1 “materiale dhe shërbime speciale” me vlerë 100 mijë lekë, në nën artikullin 602/2 “shërbime kartoteke” në vlerën 7400 mijë lekë në nën artikullin “shpenzime transporti” në masën 5000 mijë lekë , në nën artikullin 602 “shpenzime udhëtimi” në masën 3500 mijë, në “shpenzimet e mirëmbajtjes” 2500 mijë lek dhe në shpenzime të tjera operative në masën 5000 mijë lekë.

Në artikullin 231, “shpenzime për investime” vlera 2000 lekë në të cilën në mënyrë analitike po i paraqesim si më poshtë:

Për nënartikullin, “blerje e fonde librash për bibliotekën” 50 mijë lekë, për pajisje teknike 470 mijë lekë, për blerje pajisjesh zyre 1000 mijë lekë, dhe shpenzime për rikonstrukcion me vlerë 480 mijë lekë.

Për sa më sipër, këta ishin treguesit kryesorë të parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2014 për çdo artikull shpenzimesh.

Ne kërkojmë që të të miratohet nga ana juaj pasi gjykojmë se plotëson kërkesat në minimumin e mundshëm për një funksionim normal në realizimin e objektivave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2014. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Haxhiu!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit!

Takohemi në orën 16.00 me ministrin për Çështjet Vendore, Avokatin e Popullit dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive.

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretar
Armando Subashi

Përgjegjëse e sektorit të
komisioneve parlamentare
Euzheni Pengili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 19.12.2013, ora 16:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar komisioni

Rendi i ditës:

1) Miratimi i procesverbalit

2) Diskutimi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit për vitin 2014” për: Ministrinë e Pushtetit Vendor, Ministrinë për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministrinë e Brendshme (Gjendjen Civile, prefekturat), Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, M.Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Gent Strazimiri, Luan Duzha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Bledi Çuçi – ministër i Shtetit për Çështjet Vendore
Enea Hoti – këshilltar i ministrit
Fran Brahimi – drejtor në Ministrinë e Financave
Mimoza Dhëmbi – drejtoreshë e Buxhetit në Ministrisë e Financave
Milena Harito - ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike
Abana Koçiu - drejtore e Departamentit të Administratës Publike
Irma Baraku - komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
Ardiana Hala - këshilltare e komisioneres
Erion Lili - specialist i Zyrës së Financës
Flora Çabej - komisionerja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Lindita Morina – drejtore e Shërbimeve Mbështetëse
Andi Bala - këshilltar ligjor tek Avokati i Popullit
Ilirian Lole - përgjegjës i Financës tek Avokati i Popullit.
Xhenis Trebeshina - drejtoreshë e Marrëdhënieve me Institucionet dhe Organizatat në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive, këshilltare e Inspektorit të Përgjithshëm
Fjorela Beja - drejtoreshë e Financave dhe Administrimit.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë këtë mbledhje të komisionit, në vazhdim të seancave dëgjimore me institucionet e ekzekutivit dhe institucionet e pavarura.

Përpara se të fillojmë seancën dëgjimore, dëshiroj t'ju bëj me dije edhe një herë se, sikurse jeni në dijeni, janë depozituar dy dekretet e presidentit të Republikës për anëtarë të Gjykatës së Lartë, si dhe kandidaturat alternative të Avokatit të Popullit për tri komisionerë. Komisioni i Ligjeve do të zhvillojë procedurën e zakonshme në ditët e mëvonshme për njohjen e kandidaturave dhe zhvillimin e seancave dëgjimore me to, dhe natyrisht, sipas Rregullores së Kuvendit, neni 111, pika 7, do të kërkohet të plotësohet dokumentacioni nga institucionet propozuese dhe institucionet e tjera që disponojnë të dhëna rreth kandidaturave.

Për këtë arsye ne do të kërkojmë plotësimin e dokumentacionit duke filluar që nga CV-të dhe dokumentet provuese të tyre.

Pasi të kemi në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, do të vijojmë me procedurat e tjera të njohura sipas Rregullores. Arsyeja që po e ripërsëris këtë njoftim është fakti që, nëse dikush nga kolegët dëshiron që të shtojë një element të ri në këtë procedurë, gjithmonë konform Rregullores, apo të shtojë kërkesa për të marrë dokumente të tjera prodhuese rreth kandidatëve, është i mirëpritur për t'i adresuar, pasi më vonë do të jemi në limit të kohës dhe do ta kemi të pamundur dhe askush nuk do të duhet të pretendojë se përse nuk kemi marrë këtë të dhënë apo këtë dokument.

Unë i kam nisur ato dhe po pres, sapo të vijnë të jeni të sigurt se do të hyjnë në komision, se kur është kjo datë, nuk varet nga unë. Kemi dhe tri seanca Parlamenti.

Vijojmë me procedurën.

Për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore lidhur me buxhetin e shtetit është i pranishëm ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, zoti Bledi Çuçi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Do të dëgjojmë fillimisht ministrin. Kush ka pyetje, është i lirë t'i bëjë pas fjalës së ministrit.

Zoti Ministër, urdhëroni!

Bledi Çuçi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë do të bëj një paraqitje të shkurtër të shifrave për sa i përket buxhetit që do t'i kalojë qeverisjes vendore për vitin 2014. Që në fillim mund t'ju them se për vitin 2014 është parashikuar buxheti më i lartë i 5 viteve të fundit që ka marrë qeverisja vendore. Praktikisht, janë parashikuar rreth 33.1 miliardë lekë, që do të thotë se pesha që zë në prodhimin e brendshëm bruto shkon nga 2.1 për qind që ishte në vitin 2013, në 2.4 për qind për vitin 2014, pra, kemi një rritje cilësore të peshës specifike të buxhetit vendor për vitin 2014. E thënë ndryshe, buxheti i destinuar për qeverisjen vendore për vitin 2014 ka një rritje prej 16 për qind krahasuar me vitin 2013. pra, një rritje shumë cilësore, duke marrë parasysh dhe parashikimet e përgjithshme për rritjen ekonomike të Shqipërisë apo për rritjen në sektorë të tjerë. 33.1 miliardë lekë do të ndahen përkatësisht: 13.1 miliardë do të shkojnë në transfertën e pakushtëzuar, e cila ndahet sipas një formule, dhe kjo e parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2014; 5.8 miliardë shkojnë për fondin për zhvillimin e rajoneve, dhe këtu kemi përsëri një rritje, nga 4 miliardë që ishte në vitin 2013, ka shkuar në 5.8 miliardë për vitin 2014; është parashikuar që të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të shkojnë rreth 10.7 miliardë, kjo për faktin se kemi çliruar apo rritur diskrecionin e njësisë të qeverisjes vendore për të vendosur nivelin e tarifave, një kufi që është vënë që në vitin 2009 nga ligjet e njëpasnjëshme të buxhetit të shtetit, të cilat ndalonin njësitë e qeverisë vendore që tarifa e vendosur të mos kalonte 10 për qind të masës që mbliidhej nga taksa e biznesit të vogël; kemi ato që quhen “të ardhura jotatimore” rreth 2.5 miliardë dhe të ardhura nga renta minerare, dhe kjo ka një rritje të konsiderueshme, nga 300 milionë që ka qenë në vitin 2013, do të shkojë në rreth 800 milionë për vitin 2014.

Dua të theksoj edhe diçka tjetër lidhur me heqjen e taksës së biznesit të vogël. Fatura e taksës së biznesit të vogël ka qenë rreth 2 miliardë lekë, dhe kjo pritet të kompensohet nga disa mekanizma të tjerë. 1.2 miliardë do të kompensohet nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, i cili është bërë 7.5 për qind, 0.8 miliardë kompensohet si kontribut i drejtpërdrejtë në transfertën e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit, pra kapet shifra 2 miliardë, dhe përveç kësaj, vetëm nga ndryshimi i taksës së banesave pritet një rritje në buxhetet vendore rreth 1.1 miliard lekë për vitin 2014. E thënë ndryshe, janë hequr 2 miliardë dhe janë shtuar 3.1 miliardë të tjera.

Kështu që mendoj se është një buxhet, i cili jo vetëm është rritur në mënyrë të rëndësishme për sa u përket transfertave që i shkojnë pushtetit vendor, por, në të njëjtën kohë, kemi thelluar atë që quhet diskrecion të njësive të qeverisjes vendore për të vendosur dhe mbledhur tarifat në bazë të ligjit që ato kanë.

Këto ishin të përgjithshmet. Jemi të hapur bashkë me ekspertët specialistë për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të kenë zotërinjtë deputetë në lidhje me këtë buxhet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër, për ekspozenë tuaj!

Ka pyetje për zotin Ministër? Nuk ka.

Zoti Fino, si relator, urdhëroni!

Bashkim Fino – Unë në fakt e prisja që kolegët e PD-së të mos kishin pyetje, sepse e thashë edhe dje që, neni 15 i projektbuxhetit të vitit 2014 është i përgatitur mjaft mirë nga Shkëlqim Cani. Si rezultat i kësaj do të thotë se PD-ja do ta votojë nenin 15 me shumë dëshirë dhe me dashamirësi, e pres këtë gjë, do të jetë hera e parë që një nen do të votohet edhe nga opozita, pavarësisht se nuk do të votohet gjithë buxheti.

Duke falënderuar ministrin dhe kolegët e tjerë që janë këtu, dua të them në parantezë, për t'i bërë pyetje ministrit: ministri është ministër Shteti për Çështjet e Pushtetit Vendor, që ka marrë përsipër dhe ka ardhur disa herë në komisionin tonë, ne kemi dhe një nënkomision të pushtetit lokal, dhe është shumë i mirëpritur për të bërë reformat në kuadrin e decentralizimit, në kuadrin e reformës territoriale, në kuadrin e gjithë problematikës që ka pushteti vendor, dhe natyrisht, nga pikëpamja politike ai nuk mban përgjegjësi për paraqitjen e projektbuxhetit, sepse kjo është një çështje e Ministrisë së Financave, pavarësisht ekspozesë së tij shumë të saktë që ai bëri.

Pyetja që unë kam, natyrisht politike, për ministrin, por edhe teknike për stafin tjetër, është: sa është efekti i rentës minerare, pasi ne kemi një ligj i cili thotë se 25 për qind e rentës minerare i kalojnë automatikisht organit të pushtetit lokal, është baras me 800 milionë, siç na tha ministri këtu, apo kjo është një thërrime shumë e vogël që do dhe ia jep Ministria e Financave, pavarësisht se Parlamenti shqiptar ka miratuar një ligj për rentën minerare? Unë nuk besoj se në aritmetikë kam qenë i mirë, që 800 - milionëshi të jetë i barabartë me 25 për qind të ligjit të rentës minerare. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë, dhe këtë e kam pyetje politike për ministrin: a jeni dakord ju, zoti Ministër, me nenin 15 të projektligjit “Për buxhetin e shtetit”, që fatkeqësisht dhe fatmirësisht edhe PD-ja do ta votojë, mesa kam marrë vesh, se e kanë bërë ata?

Pyetja tjetër: asistimi është një nga çështjet që gjithmonë shkruhet shkarazi (është në relacion dhe nuk është në projektbuxhet). Asistimi i njësive vendore që kërkojnë të marrin hua, (e kemi të gjithë me ligj këtë) si do të bëhet, sepse ua kemi dhënë mundësinë organeve të pushtetit vendor të marrin hua, dhe ndërkohë Ministria e Financave i nxjerr 100 barriera, të cilat nuk e lejojnë të marrë hua. Në kuadrin e huasë, kur do të mbarojë më së fundi kalimi i aseteve në pronësi të pushtetit vendor, pasi ka ende që janë të pushtetit qendror dhe nuk kanë kaluar sa duhet.

Pyetja tjetër që kam, për të cilën besoj se edhe kolegët e mi deputetë socialistë do ta kenë këtë gjë; organet e pushtetit vendor të drejtuara nga socialistët kanë qenë të diskriminuar pothuajse 8 vjet: a ka pasur parasysh ky buxhet i vitit 2014, ju zotërinj të Ministrisë së Financave, një koeficient për njësitë vendore të diskriminuara politikisht gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike, sidomos për komunat, bashkitë që drejtoheshin nga socialistët? Në çdo buxhet që ne kemi marrë në këto 8 vitet e kaluara drafti i grantit të pakushtëzuar që në disproporcion të madh nga një bashki në një bashki tjetër, kur dihet fare mirë që ka një formulë, e cila, për mendimin tim, është vjetruar. Unë mendoj se ne, si nënkomision, të bëjmë një mbledhje për të diskutuar, pasi ka ardhur koha që ne t'i sugjerojmë qeverisë ta ndryshojë formulën e ndarjes së grantit të pakushtëzuar, sepse është një formulë tejet e vjetruar dhe nuk i reziston dot kohës, dhe ndarja që bëhet e grantit, në rastin konkret, është e pabarabartë nga numri i popullsisë, nga sipërfaqja e territorit të organit vendor, nga taksat që ato mbledhin. Mbase kjo do të bëhet në kuadrin e reformës së ndarjes territoriale administrative, zoti Ministër, që ju keni parashikuar si qeveri për ta bërë gjatë vitit që vjen.

Këto janë pyetjet më kryesore që kam për këtë çështje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Bledi Çuçi – Faleminderit!

Atëherë, unë po përgjigjem për atë pyetjen e drejtpërdrejtë që kisha, dhe pastaj kolegët e Ministrisë së Financave le t'u japin përgjigje gjithë pyetjeve të tjera.

Në lidhje me nenin 15. Unë jam pjesëtar i një trupe të caktuar, që është Këshilli i Ministrave, i cili ka propozuar këtë projektligj në Parlament dhe të gjitha qëndrimet e mia unë i bëj pjesë të diskutimit brenda atij organi. Përderisa projektligji është miratuar në Këshillin e Ministrave, presupozon që e ka dhe vullnetin tim politik për të kaluar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave?

Mimoza Dhëmbi – Ka disa pyetje teknike për të cilat po përpiqem të jap shpjegimin tim. Një pyetje lidhet me rentën minerare. Është një diskutim i bërë prej dy ose tre vitesh, pasi në ligjin e buxhetit, në formulën e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar ka edhe një element që lidhet me përdorimin e rentës minerare. Meqenëse formula bazë e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar ka në thelb konceptin e ekualizimit, edhe përdorimi i të ardhurave nga renta minerale përfshihet në këtë koncept, prandaj është bërë pjesë integrale e aneksit 1, i cili shpërndan të gjitha fondet e transfertës së pakushtëzuar, së bashku me rregullat për ndarjen e të ardhurave nga renta.

Nga viti në vit, që nga momenti kur ne e kemi bërë pjesë të aneksit të shpërndarjes së transfertës të pushtetit vendor, ne kemi rritur tavanin, kemi bërë një politikë të matur në përputhje edhe me kapacitetet e menaxhimit financiar që ka në komuna dhe bashki të caktuara, si dhe në përputhje me rregullin e ekualizimit. Kështu që, mund të them se në vitin 2013 janë përdorur nga renta minerare nga njësitë vendore rreth 300 milionë lekë, dhe për vitin tjetër është parashikuar 800 milionë. Kjo tregon se ne kemi lejuar hapësirën e mundshme, përveçse kemi ngritur paksa tavanin. Siç ua shpjegova herën e parë, për zonat që nxjerrin minerale e kemi ngritur në 80 për qind të grantit, pjesën tjetër e kemi lënë te 50-përqindëshi. Përveç kësaj, është edhe rritja e prodhimit të mineraleve. Të dy këto elemente do të krijojnë më shumë hapësira për të përdorur paratë e marra nga renta minerare. Por të kemi parasysh një gjë, që paratë e rentës minerare hynë në buxhet bruto dhe përdoren 25 për qind nga pushteti vendor. Pra, zëre se këto para dalin nga buxheti i shtetit.

Bashkim Fino – 25 -përqindëshin e rentës minerare, që kemi miratuar në këtë, ma përkthe pak në vlerë absolute. Më ke thënë se do të më japësh 800 milionë. Sa është vlera?

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, dakord, por pyetjen duhet ta bëni me mikrofon. Unë e kuptoj shumë mirë që ju doni të bëni edhe maxhorancën, edhe opozitën këtë. Është e drejta juaj.

Bashkim Fino – Faleminderit, Kryetar!

Unë jam këtu përfaqësues i Partisë Socialiste dhe mua më dhimbsen të gjithë kryetarët e bashkive dhe komunave. Të gjithë këshilltarët e komunave dhe bashkive janë të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, ashtu siç jemi edhe ne. Duke qenë pjesë e politikës së pushtetit vendor kam të drejtë dhe i bëra një pyetje përfaqësuesit të Ministrisë së Financave, por po e ripërsëris për ta kuptuar më drejtë dhe më saktë: 25-përqindëshin, që ne kolegët deputetë e kemi kaluar para 3-4 vjetësh në Parlament, mund të ma përkthesh në vlerë absolute, se sa është kjo shumë gjatë një viti, për një rentë minerare? Është 2 miliardë? Është 3 miliardë? Që të kuptojnë deputetët se sa është diferenca që jep Ministria e Financave nga ajo që do të merrte pushteti lokal, Ridvani vjet dha 300 milionë, dhe sivjet u dhanë 800 milionë, diçka më shumë.

E dua përgjigjen e kësaj pyetjeje, sepse dua t’ia them Saliut dhe Ridvanit herën tjetër në seancë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Dhëmbi, urdhëroni!

Mimoza Dhëmbi – Në këtë moment nuk mund t’ju them ekzaktësisht se sa janë të ardhurat nga renta, por unë mund të konfirmoj që fondi që ne kemi vendosur për të zbatuar ligjin për rentën është mbi dy herë më shumë se vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të kemi parasysh që dy ligjet janë të barabarta, ligji i rentës me ligjin e buxhetit, madje ligji i buxhetit prevalon për vitin përkatës. Kështu që ligji është në potencë i rentës minerare dhe ai gradualisht për një farë kohe do të jetë në zbatim të plotë.

Në lidhje me marrjen e huave nga njësitë vendore, mund të them që janë disa bashki të mëdha që deri sot kanë arritur të marrin hua, ka kritere dhe kushte, të cilat janë pjesë e ligjit përkatës, kështu që jo të gjithë i plotësojnë ato kritere, ka kritere që lidhen

me të ardhurat, me rritjen e të ardhurave nga viti në vit, sepse që të marrësh hua duhet të justifikosh huanë para bankës etj., etj. Ne kemi rregulla strikte për borxhin, sepse çdo hua vendore është pjesë e borxhit publik, domethënë rregullat më të forta janë te njësia vendore, e cila duhet të plotësojë shumë kritere për të arritur të marrë hua. Shtegu ligjor është i hapur, mjafton të plotësohen kriteret.

Në lidhje me pyetjen, a ka koeficient për të eliminuar diskriminimin që u është bërë njësive socialiste në fakt, nuk ka, sepse formula prej disa vitesh është e njëjta. Formula është me koeficientë fiks, të cilët miratohen të barabartë për të gjithë dhe aplikohen të barabartë, dikush humbet, dikush fiton. Për çështjen e ndryshimit të formulës, po, është e vërtetë, e konfirmojmë, edhe ne jemi dakord. Bashkë me USAID-in po punojmë që të ndryshojmë formulën në përputhje me kushtet e reja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Formula është e njëjtë dhe aplikohet njësoj për të gjithë. Në qoftë se formula sot ka 70 për qind popullsi, mund ta ketë 30 për qind popullsi dhe mund të ketë koeficientë të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Që të qetësohen të gjithë kryetarët e bashkive dhe të komunave dhe të mos kenë asnjë lloj diskutimi kur del buxheti, sepse buxheti bëhet publik dhe ata fare mirë kontrollojnë transfertën e pakushtëzuar, investimet etj., ka mundësi Ministria e Financave, sidomos drejtoria që mbulon pikërisht trajtimin për projektbuxhetin e pushtetit vendor, që kjo formulë që dhe këta kanë arritur në konkluzionin se duhet ndryshuar për t’u përshtatur më mirë me popullsinë, me sipërfaqen, me shërbimet urbane, me kapacitetet fiskale etj., të bëhet e mundur të ndryshohet dhe të bëhet një përlllogaritje qoftë edhe përpara se të na vijë nen për nen të shtunën tjetër ky buxhet për të bërë një ridraftim të ri të ndarjes së grantit të pakushtëzuar?

Fatmir Xhafaj – Zoti Ministër, zonja Dhëmbi, do të desha edhe unë që nga ju ta kishim përgjigjen për këtë pyetje!

Bledi Çuçi – Sigurisht, të gjithë biem dakord që i ka ardhur koha të ndryshojë, por një gjë e gatuar prej 12 vjetësh nuk besoj se mund të bëhet gati për 6 apo 7 ditë,

përndryshe do ta bënim më keq sesa është në qoftë se do të nxitohehim kaq shumë. Ka shumë elemente që duhen riparë, si dhe ka dhe një projekt specifik të USAID-it me Ministrinë e Financave pikërisht për këtë gjë. Kështu që, kjo është në rrugë të mbarë dhe pa diskutim që në vitin tjetër do të ketë një formulë tjetër me parametra krejt të tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Përgjigjja e zotit Ministër e ezauron përgjigjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave. Zoti ministër është autoriteti i fushës, është dhe anëtar i ekipit qeveritar.

Ka kërkuar fjalën për të bërë pyetje, zoti Bylykbashi, zonja Hysi, zoti Ndoka dhe pastaj zoti Fufi, sipas renditjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Zoti Kryetar, për procedurë, ju po veproni gabim, sepse ju iu drejtuat kolegëve se cili ka pyetje. Nuk kishte asnjë pyetje. Unë, meqë jam edhe relator, kam të drejtë të bëj dhe pyetje dhe komente në fund, dhe meqë nuk kishte asnjë, ma dhatë fjalën mua, që do të thotë se nuk mund ta marrin fjalën kolegët e mi pasi unë kam bërë gjithë këto pyetje, sepse i bie që të rimarr përsëri fjalën.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, ju keni shumë të drejtë, por për pjesën e dytë, që ju mund ta rimerrni përsëri fjalën, jam dakord.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – E falënderoj zotin Fino që shqetësohet për opozitën!

Zoti Çuçi, unë dje fola me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave në lidhje me faktin që centralizimi i mbledhjes së taksës mbi biznesin e vogël nuk ka të bëjë me decentralizimin, nuk ka të bëjë as në terma afatgjatë me forcimin e kapaciteteve të tyre në mbledhjen e taksave. Ai do të krijojë një vakuum edhe kur ne më vonë eventualisht të reformojmë të gjithë pushtetin vendor. Përveç kësaj, do ta bëjë më vulnerabël transfertën e atyre parave, që mbledhen nga pushteti qendror, te vendori, në humoret e Kryeministrit. Megjithatë, Ministria e Financave mendon se ky nuk është problem. Nuk shoh asnjë mekanizëm ligjor të garantojë që, në mënyrë precize, sapo të mbledhen paratë, të shkojnë atje.

Kisha një pyetje: duke qenë se të gjithë janë të shqetësuar, me përjashtim të qeverisë, që paketa e re fiskale që po paraqet qeveria do të çojë në rritje të evazionit; duke qenë se administrata tatimore qendrore gjithsesi nuk do të ketë një rritje të madhe, çfarë ju siguron ju që paratë për llogari të pushtetit vendor nga ky ndryshim instrumenti do të mbledhen në sasinë e nevojshme për t'ia kthyer më pas pushtetit vendor?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Bledi Çuçi – Ne edhe para dy ditësh e diskutuam këtë pikë. Në radhë të parë unifikimi i organit tatimor nuk është gjë e re as për Shqipërinë, por nuk është një formulë që nuk aplikohet edhe në vendet e tjera të Europës. Unë mendoj se nuk do të ketë asnjë pengesë, sepse nuk ka pasur pengesë as në vitin 2001 kjo gjë, pra marrja, mbledhja nga organet tatimore dhe dhënia pastaj poshtë çdo njësie vendore sipas adresës që ka biznesi. Ndërsa, përsa i përket rritjes potenciale të evazionit për shkak të ngarkesës së punës të organit tatimor, që do të duhet të mbajë tashmë dhe tatimin tjetër, mendoj që nuk ka rritje të qenësishme pasi edhe sot për nivelin dhe marzhin 5 milionë deri në 8 milionë, që është një sasi e konsiderueshme e biznesit të vogël, organi qendror tatimor ka marrëdhënie me biznesin e vogël.

Kështu që, përkundrazi, ajo çon në eficiencën, se shteti tashmë do të dërgojë vetëm një administratë tatimore te biznesi dhe nuk do të jenë dy, siç janë sot. Për sa i përket biznesit mendoj se kjo është në të kundërt të rritjes së eficiencës të mbledhjes së organeve tatimore. Edhe diçka tjetër, meqë e prekët këtë pikë duhet t'ju them se kur u decentralizua e drejta për të mbledhur taksën e biznesit të vogël, në fakt, i kemi një borxh qeverisjes vendore, sepse nuk e shoqëruam me faturën financiare përkatëse, që pak a shumë ishte te 400-500 milionë lekë në atë kohë, në mos gaboj ka qenë viti 2007. Megjithatë, njësitë e qeverisjes vendore e kapën situatën dhe e përballuan. Tani që e kthejmë mbrapsht, ne nuk po ia marrim atë, madje unë nuk e përmenda, por është rasti për ta përmendur që edhe kjo faturë 400 milionëshe mund të konsiderohet si një ekstra për njësitë e qeverisjes vendore, pasi tashmë kjo administratë tatimore vendore do të shkarkohet nga një detyrë që ka pasur për të mbledhur taksën e biznesit të vogël. Unë mendoj se nuk është rasti për t'u bërë merak se mund të rritet evazoni fiskal për këtë shkak, përkundrazi rritet efienca.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, keni folur shumë për decentralizimin e pushtetit lokal. Unë doja të pyesja nga ana financiare, përveç një rritjeje që është normale, se shkon nga viti në vit dhe nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh edhe me rritjen që i keni bërë për decentralizim fiskal, çfarë politike keni ju për taksat lokale, për ato komuna dhe bashki që kanë objekte kombëtare në territoret e tyre? Në këto territore ka hidrocentrale, siç është rasti i Fierzës, i Komanit, i Vaut të Dejës, i Ulzës, i Shkopetit, por ka edhe hidrocentrale private apo miniera. Pra, a ka ndonjë politikë qeveria që një pjesë të taksës nga fitimi t’u kalojë në mënyrë të drejtpërdrejtë këtyre komunave, duke qenë se shumica prej tyre janë malore dhe në vështirësi financiare?

Një pjesë e komunave malore janë jashtëzakonisht në vështirësi për faktin se nuk përfitojnë nga formula e famshme që ju nuk u keni ndryshuar, megjithëse keni pasur gjithë kohën e duhur në dispozicion për ta bërë një gjë të tillë për faktin se buxheti jepet edhe në bazë të numrit të banorëve dhe ato janë komuna me shumë pak banorë derisa të kryhet reforma administrative. Ka ende shumë komuna që janë pa ambiente, pa zyra. Çfarë keni menduar për këto komuna?

Pyetja e tretë: Cila është ndihma që jep ministria juaj apo qeveria në këtë rast që pushtetit lokal t’i jepet mundësi e kreditimit? Me çfarë i ndihmoni që këto nëpërmjet projekteve konkurruese të kenë mundësi të kreditohen? Është një politikë që promovohet prej disa vitesh, por realisht e keni lënë të gjithë pushtetin lokal të bllokuar dhe nuk ka asnjë lloj shprese që të gjenerojnë politika. A do të jetë e mundur kreditimi i tyre? A do të jetë e mundur që ato në mënyrë të pavarur nga qeveria të marrin projekte për zhvillimin e komuniteteve lokale?

Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Bylykbashi.)

Oerd Bylykbashi - Faleminderit, zoti Ndoka!

Zoti Ministër, keni fjalën.

Bledi Çuçi – Në lidhje me pyetjen e parë, ka dy instrumente për komunat në territorin e të cilave ka vepra të mëdha të infrastrukturës qofshin këto hidrocentrale ose miniera.

Instrumenti i parë është pikërisht kjo që diskutuam. Për sa u përket komunave që kanë miniera brenda territorit të tyre, ka një sasi parash, që quhet renta minerare, e cila u kalon drejtpërdrejt këtyre komunave. Por ka edhe një instrument tjetër, është taksa mbi ndërtesat. Kjo nuk është e përgjithshme, sepse ti ke një specifikë, ke një vepër shumë të madhe që mund të marrësh taksën që është një mundësi shumë e mirë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk është e papërfillshme. Zoti Ndoka, taksa mbi ndërtesat në Perëndim është e ardhura kryesore për njësitë e qeverisjes vendore. Po, pra nuk është taksa e biznesit, është taksa mbi ndërtesat. Kjo është, nuk ka politikë tjetër.

(Diskutime pa mikrofon.)

Jo, jo. Sot ka vetëm për minierat, pra renta minerare dhe këtë e ka vendosur parlamenti. Kur parlamenti ta vendosë që edhe për hidrocentralet duhet të jepet një koeficient i caktuar, sigurisht që do të aplikohet edhe kjo.

Për sa i përket pyetjes së dytë, në lidhje me komunat malore, formula që sapo diskutuam i favorizon drejtpërdrejt dhe një nga disbalancat që ka ardhur, për të cilën është i shqetësuar edhe deputeti Fino, vjen pikërisht prej këtij kompensimi që u bëhet komunave malore. Ka një koeficient të veçantë në formulë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar vetëm për komunat malore.

Për pyetjen e tretë do të përgjigjen kolegët e Ministrisë së Financave.

Fran Brahimi – Huatë mbështeten në një kuadër ligjor dhe në disa udhëzime. Komunat që nuk kanë të ardhura nuk mund t'i aplikojnë. Këto komuna marrin katër herë më shumë sesa marrin komunat e tjera. Ato marrin dyfish si komuna në nevojë dhe dyfish si komuna malore. Një komunë me 300 banorë nuk merr më pak se 6 milionë lekë të rinj, ndërkohë që një komunë tjetër që ka 12 mijë banorë mund të marrë më pak. Problem për këto komuna është reforma territoriale. Nëse do të ketë një reformë territoriale, edhe këto komuna do të jenë të fuqishme që të aplikojnë me hua, sepse do të bëhen edhe më të fuqishme nga pikëpamja fiskale.

Inputet që përdor një formulë mund të jenë jashtë kohe, por formula në vetvete ka të gjitha karakteristikat e një formule që ndan buxheti për njësi të pushtetit vendor. Pse? Sigurojnë ekzistencën e funksionimit të njësisë vendore kudo, në të gjithë territorin.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti drejtues i komisionit!

Zoti Ministër, te shpenzimet e buxhetit vendor thatë që janë rritur fondet dhe transfertat e pakushtëzuar. Unë kam një pyetje që lidhet me dy ligjet që ka miratuar Kuvendi: një për ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe një për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Sa është buxheti që keni parashikuar për të mbuluar shpenzimet e mekanizmave të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe për mbrojtjen e fëmijëve? Nuk flas për shërbimet sociale që i keni futur tek aneksi 5. E keni mbajtur parasysh faktin që një pjesë e bashkive nuk kanë mundësi ta mbajnë mekanizmin që të funksionojë dhe në disa bashki të tjera ky mekanizëm nuk është ngritur ende.

Oerd Bylykbashi – Po, zoti Çuçi.

Bledi Çuçi – Për nga natyra bashkitë kanë një buxhet të pavarur dhe janë të lira që buxhetin e tyre ta shpenzojnë në bazë të politikave që ato ngrenë brenda territorit të njësisë së tyre vendore. Kështu që kjo është e drejtë ekskluzive e këshillave bashkiakë sa do të alokojnë për një funksion dhe sa do të alokojnë për një funksion tjetër.

Në lidhje me faktin se në sa bashki janë ngritur këto struktura, nuk kam ndonjë informacion për të thënë diçka më konkrete. Kjo është një çështje që duhet të merret seriozisht nga ministrinë e linjës, që janë edhe përgjegjëse në bazë të ligjeve të miratuara dhe ato duhet të jenë edhe shtysa kryesore për ngritjen e këtyre strukturave që detyron ligji për t’u ngritur në njësitë vendore.

Oerd Bylykbashi - Zoti Fufi, keni fjalën.

Mhill Fufi – Faleminderit!

Çfarë efekti ka ky buxhet për ndarjen administrative në qoftë se do të ndahet një komunë e do të bëhet bashki.

Oerd Bylykbashi – Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Reforma territoriale është parashikuar që të hyjë në zbatim, në qoftë se do të rezultojë e suksesshme, për zgjedhjet vendore të vitit 2015. Kështu që për gjatë gjithë vitit ushtrimor buxhetor 2014 nuk do të ketë ndryshim komunash e bashkish.

Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e rimerr zoti Xhafaj.)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Mark Frroku.

Mark Frroku – Pyetja ime është në vazhdim të shqetësimit të kolegut tim në lidhje me rentën. Do të zbatohet ligji që është votuar nga parlamenti shqiptar për 25% të rentës apo do të vazhdohet me rritje ose me ulje të buxhetit, nga 300 thatë 800? Unë vij nga një rreth ku ka pasuri të mëdha, madje rezervat më të mëdha për sa i përket bakrit, që pastaj dalin edhe nëprodukte të tjera siç është ari, zinku.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Unë e shpjegova edhe më parë, ligji për 25% është një ligj bazë, afatgjatë, ndërsa ligji i buxhetit vjetor vë një tavan ose përcakton një formulë, e cila nga viti në vit rritet, e hap hapësirën duke shkuar drejt zbatimit të plotë të ligjit për 25%.

Unë ju shpjegova që edhe fondi në dispozicion është disa herë më i lartë, e para. E dyta, meqenëse komunat përfshihen te komunat që nxjerrin minerare, tavani është rritur nga 50 në 80, kështu që do të jenë përfituese më të mëdha këtë vit.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Ministër!

Vijojmë me Ministren e Inovacionit dhe Administratës Publike, zonjën Harito dhe zonjën Albana Koçi, drejtore e Departamentit.

Faleminderit, zonja Ministre për angazhimin tuaj në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes për buxhetin e ardhshëm! Fillimisht do të dëshironim të dëgjonim ekspozenë tuaj të shkurtër.

Fjala për ju, zonja Ministre.

Milena Harito – Faleminderit!

Prezenca këtu është prioritare karshi gjithë punëve të tjera, është detyra jonë që t’u japim llogari deputetëve.

Unë jam Ministre Shteti, pra nuk kam përgjegjësi direkte ekzekutive mbi buxhetet, sidoqoftë, meqenëse na ftuat, menduam se mund t'ju thoshim disa fjalë për çështjen e administratës publike.

Departamenti i Administratës Publike nuk është se ka ndryshime të mëdha në buxhet, sepse nuk ka investime, pra ka një strukturë pagash që mbetet pothuajse e njëjtë, me ndryshimin e vogël të inflacionit, ndërsa për Shkollën e Administratës Publike është parashikuar një dyfishim i buxhetit për trajnimet, gjë që është e domosdoshme edhe me hyrjen në fuqi të ligjit të nëpunësit civil. Për një pjesë të madhe të nëpunësve që nuk e kishin këtë status është i domosdoshëm trajnimi.

Në nivelin e pagave të administratës publike, praktikisht përveç sekretarëve të Përgjithshëm, të gjithë të tjerët përfitojnë nga taksa progresive. Sekretarët e Përgjithshëm kalojnë nga një nivel taksimi 10% në një nivel rreth 11.5%, me një shtesë shumë të vogël. Përveç atyre, të gjithë të tjerët përfitojnë nga taksa progresive sipas niveleve të strukturave të pagave, që nga specialistët bazë që përfitojnë në vit rreth 30 mijë e 248 lekë deri te drejtorët e drejtorive të cilët fitojnë 1440 lekë të rinj.

Nëse keni pyetje, jam e hapur për përgjigje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Paloka.

Edi Paloka - Zonja Ministre, meqë ju mbuloni administratën publike, unë kam një pyetje lidhur me shpenzimet. Me sa rriten shpenzimet e kësaj administrate krahasuar me një vit më parë?

Fatmir Xhafaj – Nëse e dispononi këtë përgjigje, mund t'i përgjigjeni, nëse jo, mund t'i përgjigjet zonja Dhëmbi.

Milena Harito – Zoti Paloka, mund t'ju them se mesatarisht shpenzimet e administratës pakësohen në nivelin e pagave rreth 20%.

Fatmir Xhafaj – Në vazhdim të ministres, besoj se kjo lidhet edhe me ristrukturimin, pra uljen e numrit të nëpunësve. Sa janë afërsisht shpenzimet e administratës, zonja Dhëmbi?

Mimoza Dhëmbi – Në qoftë se flasim për koston e personelit të të gjithë administratës publike prej 87 mijë vetash, fondi i pagave që ne kemi parashikuar është i njëjtë me atë të vitit 2013. E kemi shpjeguar edhe më parë, reforma në administratën

publike ka filluar nga lart, nga ministritë dhe nuk ka përfunduar ende. Në këtë buxhet nuk mund të reflektonim çdo lloj shkurtimi, madje edhe shkurtime në administratën e lartë nuk janë reflektuar të gjitha. Janë reflektuar ato që kanë përfunduar. Gjithashtu, kemi thënë që reforma do të jetë në vazhdim, por të gjitha kursimet do të përdoren për të kompensuar punonjësit e larguar, të diferencuar sipas ligjit të shërbimit civil, që marrin 1 vit të plotë pagë ose sipas Kodit të Punës që përafërsisht mund të jetë 1 vit. E kemi lënë fondin e pagave të paprekur në total për të kompensuar edhe largimet e punonjësve nga administrata. Pavarësisht se shkurtime mund të jenë llogaritur rreth 20%, në potencë ky efekt do të ndihet në vitin 2015 dhe jo në vitin 2014. Ne e kemi garantuar fondin e pagave për të gjithë, edhe për ata që janë, edhe për ata që largohen.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Paloka.

Edi Paloka – Në qoftë se e kuptova mirë, do të ketë 20% shkurtime të administratës, ndërsa fondi i shpenzimeve do të mbetet i njëjtë.

Faleminderit!

Milena Harito – Vetëm për vitin 2014. Efekti do të shikohet në vitin 2015.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam një pyetje, në fakt, për zonjën Dhëmbi. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për nëpunësin civil rritet numri i punonjësve ose i personave që përfitojnë statusin e nëpunësit civil dhe kam idenë se kjo do të ndikojë edhe në buxhet. Si e keni menduar mbulimin e rritjes së numrit të personave që përfitojnë statusin e nëpunësit civil që aktualisht nuk e kanë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Përfshirja e institucioneve të reja në shërbimin civil nuk do të jetë e menjëhershme, por do të jetë graduale. Futja në nëpunësin civil nuk do të thotë që duhet të rriten patjetër pagat. Do të ketë ndarje, rindarje, klasifikime, të cilat do të tentojnë që kostot të mos jenë të menjëhershme dhe të mëdha në buxhetin e shtetit. Sidoqoftë, fondi që ne kemi parashikuar për institucionet, që është i pandryshuar nga viti

2013, na e lejon mundësinë që për këto ndryshime të vogla afatmesme të jenë të mbuluara.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Ministre!

Milena Harito – Pika ku ka një ndryshim të vërtetë në buxhet është pika e trajnimeve, sepse ka një detyrim trajnimesh për nëpunësin civil që nuk ekziston për nëpunësit e tjerë, pra për këtë arsye është rritur buxheti për Shkollën e Administratës Publike.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi- Fakti që shërbimi civil do të shtrihet në një numër të ri më të madh punonjësish të administratës, që sigurisht, duke i klasifikuar sipas niveleve të pagave, unë besoj se mund të sjellë menjëherë rritje, por edhe duke marrë edhe në konsideratë krijimin e shkollës për administratën publike, që është një arritje e ligjit të ri, doja të dija kur e keni planifikuar që t’i shpenzoni këto para, nga data 1 prill apo nga 1 janari?

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Ministre.

Milena Harito – Në qoftë se e keni vendimin e Gjykatës Kushtetuese, unë do të doja ta lexoja.

Oerd Bylykbashi – Më jepni përgjigjen e pyetjes, datën kur do t’i filloni shpenzimet.

Milena Harito – Buxheti është vjetor.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Kur të ndahet me 4-mujor, do ju lutem t’u sillni një kopjo kolegëve deputetë.

Faleminderit që ishit sot këtu!

Radhën tani e ka Komisionerja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Flora Çabej – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Shkurtimisht më duhet të them se e di shprehjen që thotë populli “Do të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin”, megjithatë ne si institucion kërkojmë një shtesë të vogël. Kjo sepse deri në korrik të vitit 2013 ne kemi qenë të asistuar nga projekti IPA 2009, i cili ka ndikuar fort në ndërgjegjësimin dhe trajnimin e personave të ngarkuar në institucionet

qendrore publike apo e thënë ndryshe në trajnimin e oficerëve të mbrojtjes së të dhënave personale, angazhim i cili do të vazhdojë.

Duke pasur parasysh ndërgjegjësimin e subjekteve të të dhënave, pra të qytetarëve shqiptarë, jemi të detyruar të kërkojmë një shtesë për spote pikërisht për ndërgjegjësimin, i cili shkon në vlerën 2 milionë lekë.

Gjithashtu, në kuadër të ndërgjegjëimit deri tani botimi i udhëzuesve për kontrolluesit është bërë nga projekti. Tashmë do të vazhdojë ky botim i të gjitha këtyre dokumenteve ose i broshurave nga vetë zyra e Komisionerit.

Më duhet të përmend këtu edhe një shtesë tjetër, sepse na është kërkuar që ne të lirojmë zyrat për shkak se në godinën ku ne jemi ka ardhur Ministria e Zhvillimit Urban dhe Planifikimit. Ne jemi në një kat, kemi bërë të gjitha instalimet dhe me mirëkuptimin tuaj një vit më parë kemi vendosur intranetin dhe nëse do të lëvizim, siç na kanë thënë, na duhet të ribëjmë edhe njëherë nga e para të gjitha këto instalime dhe këto shpenzime të tepërta.

Në këtë kuadër, për këto që përmenda, ne kërkojmë një vlerë prej 4 milionë lekësh të rinj për t'i mbuluar të gjitha këto shpenzime. Nuk di sesa do ta kem mirëkuptimin nga zonja Dhëmbi, por shkurtimisht këto ishin. Më duhet të them që për sa u përket akteve nënligjore duhet të luftojmë shumë për ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Fatmir Xhafaj – Nuk është objekt i kësaj mbledhjeje, do të kemi rast tjetër, por në funksion të kërkesës, ndoshta keni të drejtë.

Kolegët kanë ndonjë pyetje?

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Çabej!

E kuptoj shumë mirë rëndësinë që kanë edhe intraneti, edhe spotet, por do të doja të dija, nga gjobat që ju mblidhni, sa për qind të tyre mbani, apo i dorëzoni të gjitha në buxhetin e shtetit?

Faleminderit!

Flora Çabej – Faleminderit!

Ishte një pyetje shumë e mirë. Më duhet t'ju them që vitin e kaluar kur kemi kaluar amendimet e ligjit, kemi kërkuar që të mbanim të paktën 50% të gjobave, por,

fatkeqësisht, Ministria e Financave vendosi që të gjitha të kalojnë në buxhetin e shtetit. Pikërisht kjo ishte edhe arsyeja që u rritën gjrobat, pavarësisht se me rritjen e gjobave shumica e tyre tani janë ankimuar në gjykatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vlerën nuk e kam, por nuk mund të them, sepse janë mbledhur gjrobat e vjetra që kanë qenë në vlerë të vogël. Të gjitha gjrobat që janë tani 5 milionë lekë të vjetra apo 10 milionë lekë të vjetra, janë ankimuar në gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Çabej!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë? Jo.

Zonja Dhëmbi ka vend për shtrëngim, apo për çlirim?

Mimoza Dhëmbi – Po t'i shohësh shifrat historike, normalisht me buxhetin e shpenzimeve korrente ne kemi bërë një shtesë, 1 milion lekë, por i bie të jetë 10%, pavarësisht se në shifra relative mund të duken shumë. Duke marr parasysh disa faktorë që janë specifikë vetëm për këtë vit, siç ishte puna e transportit ose trajnimet, meqë nuk ka më projekt të huaj, unë mendoj se mund të shihet diçka rreth 2 milionë te shpenzimet korrente.

Fatmir Xhafaj – Unë do të bisedoj edhe me zonjën Dhëmbi, edhe me sekretarin e Përgjithshëm për të parë mundësinë, sepse me sa kam dijeni unë ministria do të shkojë në një vend tjetër. Kam marr një informacion të ri që duhet ta verifikoj.

Ka ndonjë shqetësim tjetër? Jo.

Faleminderit, zonja Çabej!

Për pjesën e spotit?

Mimoza Dhëmbi – Është kërkuar çdo vit, por nuk është dhënë asnjëherë.

Fatmir Xhafaj – Zonja Dhëmbi, nuk keni ndonjë mundësi?

Flora Çabej – Ne kemi dy spote të 2009-ës nga OSBE-ja, por ato kushtojnë shumë për t'i shfaqur në mediat private kombëtare. Kemi gjetur mbështetje vetëm te TVSH-ja për muajin janar, sepse 28 janari është Dita Europiane e Mbrojtjes së të Dhënave.

Fatmir Xhafaj – Do të vijë ligji për AMA-n dhe TVSH-në në janar dhe unë ju premtoj që do të jem deputeti që do të llojë vendosjen e dispozitave.

Faleminderit!

Tani e ka radhën komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Zonja Baraku, zonja Hala, këshilltare e komisioneres, dhe zoti Lili, specialist i zyrës së financës janë prezentë.

Zonja Baraku, ju lutem bëni një ekspozë të përmbledhur!

Irma Baraku – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Në komentet që ne kemi dërguar jemi fokusuar jo në të gjitha kërkesat për shtesë që kemi bërë pranë Ministrisë së Financave, por në tri pika shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për funksionimin e institucionit. Kemi kërkuar shtesë në zërin e shpenzimeve, sepse kemi një domosdoshmëri për të rritur aktivitetet ndërgjegjëse. Fakt është që në dy vjetët e mëparshëm kemi pasur mbështetje nga projekte bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, ndërkohë që këtë vit nuk ka parashikime për aktivitete ndërgjegjëse, por kryesisht për botime, trajnime etj. Kështu që mbetet një aspekt i pambuluar ose i mbuluar pjesërisht, që është edhe një ndër kompetencat themelore që ka komisioneri: ndërgjegjësimi i publikut në tërësi dhe i grupeve të veçanta për çështjet e diskriminimit.

Së dyti, meqenëse vitet e mëparshme jemi përqendruar kryesisht në aktivitetet ndërgjegjëse, mendojmë se tani mund të kemi kapacitetet e nevojshme, dhe kërkohet mbështetja financiare, për realizimin e monitorimeve, të sondazheve e studimeve në fushën e çështjeve të diskriminimit.

Një aspekt tjetër, për të cilin ne kemi kërkuar shtesë në këto shpenzime, ka të bëjë me domosdoshmërinë për të pasur një automjet në dispozicion të institucionit. Ne kemi shpjeguar aty që është një automjet në një gjendje skandaloze, që ka shpenzime 50% më shumë se çfarë duhet. Mirëpo kjo lidhet me funksionimin themelor, nuk është për të krijuar komoditet për institucionin, për faktin se mbi 50% e ankesave që paraqiten pranë komisionerit dhe kanë nevojë për hetime e inspektime ndodhen jashtë Tiranës dhe kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Por edhe ndërgjegjësimi kërkon përsëri përdorimin e një automjeti. Ne nuk shkojmë vetëm si individë, por të pajisur me mjete të ndryshme ndërgjegjëse, me pako të ndryshme, që i shpërndahen jo vetëm komunitetit në përgjithësi, por edhe organeve të pushtetit vendor. Pra është e domosdoshme që ta kemi këtë automjet. Është një kërkesë e vazhdueshme, që

besoj nuk ka ndryshuar gjatë 3 vjetve të ekzistencës së institucionit. Një domosdoshmëri tjetër është pajisja e ndërtesës me një ashensor.

Për këtë ka disa arsye: e para që institucioni i komisionerit është në katin e dytë dhe nuk ka mundësi për të pasur një zyrë në katin e parë. Kjo lidhet me thelbin e funksionimit të këtij institucioni, sepse një ndër grupet vulnerabël që duhet të ketë prezencën më të shpeshtë pranë komisionerit janë personat me aftësi të kufizuar. Nëse ne kemi bërë një përshtatje gjatë rikonstruktimit të zyrave me elemente që janë të domosdoshme për personat që nuk shikojnë etj. por personat para dhe tetraplegjik është e pamundur që të kenë akses brenda zyrave të institucionit.

E dyta, me një shkresë që na është dërguar nga Kryeministria ka një prioritet të qeverisë për ngritjen e grupit ndërministror për zbatimin e rregullave të përshtatshmërisë ndërtimore në institucionet shtetërore qendrore dhe vendore dhe besoj se kjo shkon në përshtatje edhe me vetë këtë urdhër të Kryeministrit. Më e rëndësishme është se ne do të trajtojmë çështjet e përshtatshmërisë, përshtatjes së arsyeshme si ndër format e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar dhe duhet ta fillojmë nga vetja, sepse nuk mund t'ia kërkojmë asnjë institucioni tjetër në qoftë se ne si institucion që japim rekomandime dhe vendime për diskriminim për shkak të mohimit të përshtatjes së arsyeshme nuk e kemi një gjë të tillë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Baraku!

Ka pyetje?

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Baraku për prezencën!

Unë kam një pyetje si për ju, ashtu edhe për zonjën Dhëmbi.

Buxheti që është parashikuar për komisionerin është në rritje krahasuar me një vit më parë? Sa për qind e buxhetit shkon për monitorimet dhe sa për qind e buxhetit do të shkojë për të përmbushur rekomandimet që ka bërë Komisioni European kundër racizmit dhe tolerancës për këtë vit që vjen? Besoj keni marr informacion që në shtator të vitit 2014 Shqipëria monitorohet dhe ju do të jeni në proces monitorimi nga Komisioni European. Unë dua të di çfarë mundësi keni me buxhetin që ju ka dhënë qeveria për të përmbushur të gjitha detyrimet që ju janë lënë në raport si rekomandim?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Baraku.

Irma Baraku – Me shtesën që unë kam këtu është shifra 2 milionë të rinj. Unë them që edhe në këtë vlerë është i mundur realizimi i katër konferencave në mes të Tiranës, por nuk besoj se konferenca është mënyra e vetme për ta ndërgjegjësuar komunitetin, nuk është e mjaftueshme për të realizuar monitorimet dhe sondazhet që tashmë duhet të jenë, as për të plotësuar ato detyrime që përmendi zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Ju kërkuat ashensorin, monitorimet dhe një automjet. Unë jam absolutisht dakord, madje do t'i thosha zonjës Dhëmbi t'i shikonte, por keni një përllogaritje se sa është shuma?

Irma Baraku – 11 milionë të rinj. Po flasim vetëm për ato që kërkuam këtu, sepse i kemi lënë pjesët e tjera.

Mimoza Dhëmbi – Ne mendojmë që një shtesë modeste e kemi bërë në buxhetin e komisionierit, pavarësisht se e kuptojmë që nevojat e institucionit, sidomos të institucioneve të reja nuk plotësohen asnjëherë në mënyrë maksimale, por të paktën nevojat e funksionimit janë të mbuluara me këtë buxhet. Për sa u përket çështjeve specifike, shteti mund t'iu gjej një zyrë në katin e parë, pse të mendojmë ashensorin, ndërkohë që mund të ketë zgjidhje tjetër alternative, që është zyra në kat të parë.

Për automjetin ne kemi atë formulën magjike, jemi të prirur për të mos parashikuar automjete të reja në buxhetin tonë dhe gjithmonë ju rekomandojmë institucioneve të gjejnë te rezerva e shtetit automjete të përdorura, të konfiskuara etj.

Irma Baraku – Në fakt, ne kështu e kemi gjetur. Automjeti ka ardhur nga rezervat e shtetit, por po ta kishim blerë do të kishim harxhuar shumë më pak sesa kemi harxhuar për mirëmbajtje, për karburant etj. plus që është një institucion i ri dhe nuk ka pasur automjet përpara që po kërkohet një blerje e re.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino e ka fjalën.

Bashkim Fino – Projektbuxheti i Komisionierit për Diskriminim është relativisht i mirë në raport me vitin e kaluar. Unë do ta mbështesja propozimin e fundit të komisioneres, pavarësisht propozimit që bën Ministria e Financave që ne nuk japim makina. Ky është një institucion i ri dhe nuk ka asgjë të keqe, sepse ka gjithmonë një herë të parë për të gjitha institucionet, të cilave ju janë vënë në dispozicion nga buxheti i

shtetit makina. Mund të vihet një fond relativisht modest që të mos pretendohet të merret makinë luksi, por një makinë që t'i shërbejë institucionit. Kjo nuk përbën një gjë të jashtëzakonshme. Metoda e zonjës Dhëmbi është përdorur, duke marr nga rezerva e shtetit dhe është në kushte të disfavorshme. Tani të përdoret metoda tjetër. Ne si komision, që e kemi në varësi këtë inspektorat, propozojmë të jepet një fond modest për të blerë një makinë.

Unë si relator e propozoj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vazhdojmë me Zyrën e Avokatit të Popullit. Nga Avokati i Popullit janë prezent zotërinjtë, Andi Bala, këshilltar ligjor, dhe Ilirian Lole, përgjegjës finance.

Fjalën e ka zoti Bala për një ekspozë të shkurtër.

Andi Bala – Do të flas shumë shkurt. Nëse do t'i rendisja kërkesat plus që kemi bërë për buxhetin, për nga rëndësia do të ishin vetëm dy: zyrat rajonale, që është një kërkesë që bëhet si nga Komisioni i Akreditimit të Kombeve të Bashkuara, por parashikohet edhe në planin tonë strategjik, dhe komisionerët ose stafi që mendohet të krijohet brenda institucionit të Avokatit të Popullit, i cili do të merret me të drejtat e fëmijëve, që është një ndër rekomandimet që ka bërë Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Balaj, ju jeni të kënaqur nga buxheti, kështu që nuk besoj se ka pyetje dhe komente.

Andi Bala – Kërkesat tona janë ato që janë në dokumentacion. Pa dyshim që nuk është e njëjta shumë, prandaj unë thashë që në qoftë se do t'i rendisnim nga rëndësia, primare dhe të domosdoshme janë dy të parat. Arsyet janë të shpjeguara në dokumentacion.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, vetëm një pyetje.

Vasilika Hysi – Zoti Bala, mundësia për krijimin e Komisionerit për të Drejtat e Fëmijëve është e mbuluar më buxhet, apo jo? Jo

Sa është shuma që ju kërkoni?

Andi Bala – Shuma që ne kërkojmë për këtë seksion është 4 milionë e 85 mijë lekë. Vetëm paga. Kurse për zyrat rajonale është 8 milionë e 170 mijë. Vetëm paga.

Ilirian Lole - Momentalisht janë dy dhe do të ngrihen edhe dy të tjera. Gjithë pajisjet e zyrave plotësohen nga projekti danez, kurse pagat e stafit duhet të përballohen prej nesh.

Vasilika Hysi – Në fakt, unë doja një përgjigje nga zonja Dhëmbi dhe dua të jap edhe një informacion për zonjën Dhëmbi dhe për relatorin, zotin Fino. Ne kemi kaluar në parlament një rezolutë ku një nga angazhimet e Kuvendit në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit është të mendojmë ose të inkurajojmë ngritjen e Komisionerit për të Drejtat e Fëmijëve.

E dyta, lidhur me ngritjen e zyrave rajonale është lënë një rekomandim nga Komisioni European kundër racizmit dhe intolerancës për të forcuar ndikimin ose prezencën e institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit në nivel vendor, për çka do të monitorohemi në vitin 2014. Unë nuk e di sa i ka bërë qeveria e kaluar, por me sa kuptojmë nuk kanë funksionuar të katërta zyrat.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino e ka fjalën.

Bashkim Fino – Ajo që do të thosha unë, është se buxheti i Avokatit të Popullit këtë vit, siç e shprehën edhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, është i kënaqshëm, sepse po të shohësh shifrat e 2013-s dhe 2014-ës, në 2013-n kanë përfituar rreth 30 milionë. Gjithsej bashkë me financimet në total i shkonte 87 e 450 milionë, ndërsa tani shkon 127,9, pra 128. Nga të cilat 36,4 janë donacione të huaja nga danezët. Nëse fut edhe 4 milionë nga buxheti i shtetit, pra ke marrë 1 më shumë në raport me vitin 2013, edhe numrin e punonjësve e ke rreth 48, unë mendoj se brenda financimit danez mund të bëhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të kemi edhe buxhetin e vitit tjetër, që mund të japim financime. Më duket një shifër shumë më e konsiderueshme, megjithatë nëse Ministria e Financave sheh hapësirë për rritjen e numrit dhe unë mendoj që te pasqyra e numrit të punonjësve për vitin 2014, po ta shikoni me kujdes, Avokati i Popullit ka 48, në total në Republikë janë 86 mijë 449 punonjës, duke futur gjithë ministritë e linjës dhe le të themi që ka një rezervë prej 51 vetash që janë në nomenklaturë të Këshillit të Ministrave për institucione të reja që mund të krijohen. Në qoftë se ka mundësi dhe hapësirë t’ia propozojmë Ministrisë së Financave

për dy vetë, të paktën të shtojmë dy vende për projektin danez, nuk do të ishte keq se edhe Avokati i Popullit mund të bëhej me 50 vetë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Fjalën e ka zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Me sa kuptova unë propozimi i zotit Fino ishte se si mund të gjejmë mënyrën që të riallokojmë këtë numër ekzistues që kemi që të kryej edhe këtë funksion të ri.

(Diskutime pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Meqenëse e kam shumë larg zonjën Dhëmbi dhe nuk e kupton, unë thashë që numri i punonjësve të Avokatit të Popullit është 48 dhe ne ta bëjmë 50, sepse kemi një rezervë në numrin e përgjithshëm. I kanë mundësitë dhe hapësirat, sepse kanë rreth 51 vende rezervë për institucione të reja, siç mban gjithmonë Këshilli i Ministrave.

Fatmir Xhafaj – Zonja Dhëmbi ndonjë koment?

Mimoza Dhëmbi – Në qoftë se me një shtesë prej 2 punonjësish, ne mbulojmë një funksion dhe mund ta quajmë të bërë, më duket me kosto të lehtë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Faleminderit, zotërinj përfaqësues të Avokatit të Popullit!

Shpresoj të keni mbetur të kënaqur nga ky inkursion i parë juaji në komision!

Nga institucioni i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive kanë ardhur zonja Xhenis Trebeshina, drejtoreshë e marrëdhënieve me institucionet dhe organizatat, këshilltare e Inspektorit të Përgjithshëm, dhe zonja Fjorela Beja, drejtoreshë e Financave dhe Administrimit.

Ju lutem, një paraqitje të shkurtër rreth komenteve tuaja për buxhetin dhe nëse eventualisht keni ndonjë kërkesë të mundshme.

Fjorela Beja – Në radhë të parë ju falënderojmë për shtesën!

Për projektbuxhetin e vitit 2014 jemi parimisht dakord. Është në nivelet që ne kemi planifikuar dhe parashikuar vetë si institucion, kështu që nuk kemi vërejtje. Kemi ardhur për të shprehur dakordësinë tonë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zona Beja edhe për qartësinë, edhe saktësinë tuaj, edhe për vlerësimin që jepni ndaj qeverisë dhe Kuvendit për mbështetjen që ju ka dhënë!

Fjalën përpara se ta mbyll fjalën e ka relatori.

Bashkim Fino – Shyqyr që janë të kënaqur këta të deklaramit të pasurive se në vitin 2013 kanë pasur 43 punonjës, tani janë shtuar 9 punonjës dhe kanë shkuar 52. Fondi ka qenë 93 milionë në vitin 2013, tani shkon 104 milionë. Shumë mirë në raport me institucionet e tjera. Tani i kanë të gjitha mundësitë dhe hapësirat për të bërë tamam detyrën, që nuk e di sa do ta bëjnë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Përpara disa muajve keni kaluar një strukturë të re të inspektoratit që përmbante 9 veta më tepër dhe atëherë ne ju thamë që brenda ligjit të buxhetit ekzistues nuk mund të shtohet numri i punonjësve, sepse tavanit është në ligjin e buxhetit. Tani po e reflektojmë në ligjin e buxhetit. Prandaj ka shtesa, ka 9 punonjës, që ju i keni miratuar në strukturë.

Fatmir Xhafaj – E ka kaluar parlamenti këtë? Në rregull atëherë.

Në varësi me efektivitetin e institucionit do të jetë edhe qëndrimi i maxhorancës.

Këtu mbyllim këtë mbledhje të gjatë.

Përpara se ta mbyll, dëshiroj t’ju bëj me dije që nesër në orën 10:00 e në vazhdim do të jenë: Komisionin Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni i Shërbimit Civil, ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri, Shkolla e Magjistraturës, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Presidenca.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretar
Armando Subashi

Përgjegjëse e sektorit të
komisioneve parlamentare
Euzheni Pengili

